

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-** Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj, si kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët Kymete Kicaj e Gani Kastrati anëtarë, me procesmbajtësen Birsen Kume – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarve, F. Sh. nga fshati P. Komuna e Suharekës dhe E. K. e A. K. nga Suhareka, për shkak të veprës penale vrasje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prizren PP.nr. 231/2012 të datës 27.12.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarve, mbrojtësve të tyre av. E. R., av. K. K. dhe V. O. si dhe av.R. D., të dëmtuarës Z. K., si dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar av. H. K., më datë 18.04.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

**1. F. SH.**, nga i ati I. dhe e ëma N., e lindur K., data e lindjes... në fshatin P., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**2. E. K.**, nga i ati J. dhe e ëma N., e lindur Sh., data e lindjes... në fshatin P., Komuna e Malishevës, tani me banim në Suharekë, me punë të përkohshme në Itali, i martuar baba i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**3. A. K.**, nga i ati J. dhe e ëma N., e lindur Sh., data e lindjes... në Suharekë, ku edhe tani jeton, me punë të përkohshme në Itali, i martuar, ka të kryer shkollën fillore dhe 3 vite të shkollës së mesme, punëtor në ndërtimtari, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## JANË FAJTOR

Sepse me datë 02.08.2012 rreth orës 16:30 minuta, në rrugën “S.”, pikërisht në rrugën përball shtëpive të J. K. dhe N. K., si bashkëkryerës me dashje e privojnë tjetrin nga jeta, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje paraprake në mes të familjes së J. K. dhe I. Sh. në një anë dhe familjes së N. K. në anën tjetër, e në momentin derisa kishte përleshje fizike mes të anëtarëve të këtyre tri familjeve, i akuzuari E. K. pajiset me një hu druri i afrohet të dëmtuarit B. K. i cili në atë moment ishte duke qëndruar përpara shkallëve të shtëpisë së tij dhe të njëjtin e godet me atë hu në kokë, e pikërisht në regjionin e veshit të djathtë, pastaj edhe i akuzuari F. Sh. i cili ishte i pajisur me një hu druri të gjatë për afërsisht mbi një metër e godet të dëmtaurin, tani të ndjerin B. K. në kokë, pikërisht në tepin e kokës, me ç’rast i dëmtuari fillon të dridhet dhe rrëzohet në tokë duke e humbur vetëdijen, duke qenë ashtu i shtrirë në tokë i akuzuari A. K. i afrohet të dëmtuarit dhe i thotë “nëse

nuk të vras këtu kam me të vra në Itali” dhe me një shufër metalike e godet të dëmtuarin, tani të ndjerin B. në kokë, kështu të dëmtuarit tani të ndjerit B. K. i shkaktojnë lëndime trupore si thyerje të ashtit ballor të djathtë, ashtit tamthor të djathtë, ashtit zverkor dhe qatisë së orbitës me dëmtime të trurit të shoqëruara me gjakderdhje në zona të ndryshme trunore që kanë ardhë si pasojë e thyerjeve të shumfishta të kafkës, i dëmtuari, tani i ndjeri B. K., si pasojë e goditjeve të marra vdes me datë 09.08.2012 në QKUK - Prishtinë.

- Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të vrasjës nga neni 146 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 3, 7, 11, 15, 34, 38, 64, 146 lidhur me nenin 23 të KPK, të akuzuarit i:

## **G J Y K O N**

Të akuzuarin **F. Sh.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 14 (katërbëdhjetë) vjet, në të cilën dënim do i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 02.08.2012.

Të akuzuarin **E. K.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjet, në të cilën dënim do i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 11.09.2014.

Të akuzuarin **A. K.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjet, në të cilën dënim do i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 11.09.2014.

Të dëmtuarit Z. K. dhe V. K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet të akuzuarit F. Sh., E. K. dhe A. K. që kësaj gjykate t’ia paguaj shpenzimet e procedurës penale, si dhe shpenzimet për paushallin gjyqësor secili prej nga 1000 (njëmijë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbaramit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.231/2012 të datës 27.12.2012 kundër të akuzuarve F. Sh. nga fshati P., Komuna e Suharekës, E. K. dhe A. K. nga Suhareka për shkak të veprës penale vrasje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare të cilën e ka dorëzuar edhe me shkrim ka deklaruar, se gjendja faktike në këtë çështje penale pamëdyshje është vërtetuar pjesërisht nga deklaratat e të akuzuarit F. Sh. të dhënë në prokurori dhe gjykatë dhe nga deklaratat e dëshmitarëve të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësorë R. H., V. K., Sh. K., Z. K., Gj. K., V. K., S. K., N. K., N. K., si dhe nga raporti i autopsisë, superekspertizës mjeko-ligjore e dt.07.07.2015. Prokurori i shtetit thekson se nga deklaratat e lartcekurve pa mëdyshje është vërtetuar se para ditës kritike familjet e J. K. dhe I. Sh. në një anë dhe familja e N. K. në anën tjetër i kanë pas raportet e acaruarat me faktin se të njëjtit nuk kanë qenë në dasmën e N. K. Të gjithë dëshmitarët kanë pohuar se ditën kritike ka filluar rrahja në mes të familjarëve të tre familjeve. Prokurori më tej ka theksuar se nga deklaratat e dëshmitarëve Sh. K., Z. K., Gj. K., V. K. e dëmtuara V. K., se të ndjerin B. K. në kokë e kishte goditur F. Sh. me një hunjë druri, dhe po ashtu me hunjë druri e ka goditur edhe E. K. dhe pasi që ai është rrëzuar në tokë i është afruar A. K. ku me një hebëll metalike e ka goditur të ndjerin B. K. duke i thënë se “ nëse nuk të vrasë këtu ka me të vra në Itali “, të cilat fakte i vërtetojnë edhe dëshmitarët N. dhe S. K.

Prokurori më tej ka theksur se këto deklarata gjejnë mbështetje edhe nga raporti i autopsisë MA -12-198, supersekserptiza mjekoligjore e punuar nga Dr. N. U., Dr. F. D. dhe Dr. V. K. si dhe nga deklaratat e tyre të ekspertëve të mjekësisë ligjore të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë, ku është vërtetuar se të ndjerit i janë shkaktuar lëndime në regjionin ballor të kokës rreth 10 cm mbi vetullën e djathtë dhe rreth 1 cm nga vija e mesme e kokës me diametër rreth 2 cm, e cila paraqet një plagë shqyese e shkaktuar nga veprimet mekanike të mjetit të fortë mbretës, e që sipas autopsisë shkaktari i vdekjes është i dhunshëm si pasojë e dëmtimit të trurit e shoqëruar me gjakëderdhje në zonat e ndryshme të trurit, e si rrjedhojë e thyerjes të shumta të kafkës nga veprimi mekanik të mjetit të fortë mbretës, i cili fakt vërtetohet edhe supersekspertiza mjekoligjore e cila në tërësi e mbështet raportin e autopsisë. Motivi i kësaj vrasje ishte mosmarrëveshja paraprake që kishte lindur në mosardhjen në dasmën e N. K. nga ana e familjarëve të akuzuarve I. Sh. dhe J. K., të tret të akuzuarit F. Sh., A. dhe E. K. me vetëdijen e tyre ishin dakorduar që të veprojnë së bashku në kryerjen e kësaj veprë penale e cila është objekt i akuzës, duke qenë të vetëdijshëm veprimi i tyre hynë në përbërjen e të akuzuarve të tjerë, duke theksuar se veprimi i të akuzuarve veç e veç në këtë drejtim është paraqitur si në tërësi dhe ka kontribuar në kryerjen e veprës penale, pasi që të tre të akuzuar kanë marrë pjesë në kryerjen e veprimeve të tyre dhe nga të lartcekurat në veprimet e të akuzuarve secilit veç e veç janë formuar elementet esenciale të veprës penale të vrasjes, duke propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor për këtë veprë penale dhe të shqiptohet dënimi i parapara me ligj.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. Sh. – av. E. R. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në shqyrtimin gjyqësorë pas administrimit të provave është vërtetuar se me dt.02.08.2012 pas një mosmarrëveshje paraprake në mes të familjes të pandehurit J. K. e I. Sh. në një të anë dhe familjes së N. K. në anën tjetër, pas një përlëshje është lënduar rëndë B. K. i cili pas disa ditësh kishte vdekur në QKUK në Prishtinë. Nga dëgjimi i ekspertëve mjekoligjor dhe pas supersekspertizës si dhe marrjen në pyetje të tyre në shqyrtimin kryesor rrjedh se tani i ndjeri ka vdekur si pasojë e gjakëderdhjes së brendshme trunore e si rrjedhojë thyerje të shumfishta të kockave të kafkës dhe bazës së kafkës e të cilat thyerje janë pasojë e plagës vdekjeprurëse thyerje në regjionin e djathtë ballor të kokës si dhe të thyerjeve e sinuseve ballorë, mollëzorë dhe sfondit të anës së djathtë. Në vazhdim ka theksuar se në bazë të gjendjes së vërtetuar dhe provave të administruara nuk mund të qëndrojë akuza për veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK-së sepse vdekja e të ndjerit ka ndodhur pas një përlëshje të papritur. Andaj në veprimet e të pandehurit F. Sh. mund të formohen tiparet e veprës penale të pjesëmarrës në rrahje nga neni 155 par.2 të KPK-së. Ndër tjera mbrojtja ka theksuar se të gjitha veprimet të cilat i ka ndërmarrë i mbrojturi i tij F. Sh. është se i njëjti pasi që ka parë të atin e tij të përgjakur dhe duke qenë vetë i sulmuar është mbrojtur në mënyrë që mjetin me të cilin është sulmuar, hunin e ka marrë prej dorës së sulmuesit tani të ndjerit B. dhe me këtë hu e godet në kokë, në mënyrë për të zmbrazur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm nga vetja dhe personit tjetër, duke konsideruar se karakteri i mbrojtjes ka qenë proporcional që ka paraqitur sulmi, mbrojtja konsideron se të gjitha veprimet e të pandehurit kanë karakterin e mbrojtjes së nevojshme. Atëherë meqenëse vepra është kryer në mbrojtje të nevojshme konsideron se kjo nuk është veprë penale, duke i propozuar gjykatës që për shkak të mungesave të provave se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet ose ndonjë veprë penale tjetër në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së të lirojë nga akuza.

Mbrojtësit e të akuzuarit E. K. – av. K. K. dhe V. O. në fjalën e tyre përfundimtare kanë deklaruar se fillimisht mbeten pranë fjalës përfundimtare të dhënë në gjykimin e parë të kësaj çështje penale – juridike, duke shprehur befasinë dhe lidhur me qëndrimin e prokurores së çështjes e cila në tërësi ka mbetur pranë aktakuzës edhe pas administrimit të provave të cilat kanë vërtetuar një gjendje faktike krejtë ndryshe nga ajo e përshkruar nga dispozitivi i akuzës, duke konsideruar se kjo aktakuzë është e mangët dhe e përpiluar në kundërshtim me nenin 305 të KPP-së respektivisht me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilat dëshmojnë diçka krejt tjetër nga ajo që thuhet në

aktakuzë. Ndër të tjera ka theksuar se nga dëgjimi i deklaratave të shtatë dëshmitarëve të cilët në mënyrë të detajuar sqarojnë motivin, arsyen dhe rrethanat se si dhe cilat palë kanë qenë në konflikt dhe kush me kënd ka pasur mosmarrëveshje, pra të gjithë dëshmitarët në mënyrë identike kanë përjashtuar pjesëmarrjen e të mbrojturit të tyre në përlëshje, duke përjashtuar çfarëdo veprimi inkriminues të tij në ngjarjen e ditës kritike. Po ashtu nga dëshmia e tre anëtarëve të familjes Sh. të cilët po ashtu në mënyrë identike kanë përjashtuar çdo veprim inkriminues apo pjesëmarrje në rrahje të mbrojturit të tyre, ku ka përfunduar me pasoja vdekjes të ndjerit B. siç pretendohet në aktakuzë. Ndërsa në anën tjetër ka theksuar se katër dëshmitarë të familjes N. K. të cilët me deklaratat diametralisht të kundërta njëra me tjetrën në fazat e ndryshme të kësaj procedure penale si dhe kontraktitore jashtëzakonisht të madhe me vetveten. Po ashtu edhe nga deklaratat e gjashtë dëshmitarëve të familjes J. K. të cilët kanë dëshmuar në pafajësinë e E. K. Andaj në mes tjerash mbrojtja ka theksuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar gjatë procedurës se përfaqësuesja e aktakuzës e cila sipas ligjit kërkohet të argumentojë fajësinë e të akuzuarve pasi që pafajësia e tyre prezumohet, në rastin konkret nuk ka arritur në asnjë mënyrë të sigurt dhe të pakontestushme të argumentojë fajësinë e të mbrojturit të tyre E. K. dhe për këto arsye gjatë shqyrtimit kryesorë, kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë relevante se i mbrojturi i tyre ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet. Andaj nga gjykatës i kanë propozuar lirimin e të mbrojturit të tyre nga akuzat, e këto e kërkojnë nga parimi i njohur romak in dubio pro reo, pasi që këtë e kërkon drejtësia meqë në jetë asgjë nuk matet më saktë se drejtësia, meqë padrejtësia nuk matet fare, prandaj nga të gjitha të larcekurat kjo gjykatë të merre aktgjykim lirues për E. K.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. K. – av. R. D. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se ka mbështetur fjalët e kolegëve paraparak e në veçanti fjalën përfundimtare të koleges, meqë edhe pozita e të mbrojturit të tij është identike me atë të akuzuarit E., përkatësisht vëllait të tij, në mos edhe më rëndë, për faktin se i mbrojturi i tij gjatë jetës së tij, shumicën e kohës ka kaluar me të ndjerin B. Në vazhdim mbrojtja ka theksuar se përshkrimi i veprës në aktakuzë e bazuar në nenin 305 të KPP-së nuk është i qartë, pasi që nuk përmban fare përshkrimin e rrethanave të nevojshme të cilat do të përcaktonin me saktësi se për çfarë veprë penale përgjithësisht kemi të bëjmë këtu, po ashtu nuk përmban përshkrimin e saktë të ngjarjes së zhvilluar se kush e shkaktojë një dhe të vetmen plagë vdekjeprurëse në pjesën ballore të kokës tani të ndjerit B. dhe shumë detaje të tjera të domosdoshme për një dispozitiv të aktakuzës në të cilën ngarkohen tre të akuzuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të vrasjes me një plagë vdekeprurëse, pra konsideron se dispozitivi të aktakuzës nuk përmban as përshkrimin e qartë të rrethanave në të cilat është zhvilluar ngjarja kritike si dhe të veprimeve konkrete të mbrojturit të tij. Sipas mbrojtjes, përfaqësuesja e aktakuzës nuk ka arritur të e argumentojë aktakuzën as në fazën vijuese procedural, në shqyrtimin kryesor, pasi gjykatës nuk ka ofruar prova me të cilat do të vërtetohet ekzistimi i veprës penale dhe përgjegjësisë penale të mbrojturit të tij A. K., duke e mbetur e pa sqaruar se cili është veprimi të cilin e ka ndërmarrë i mbrojturi i tij dhe cilat ishin pasojat e atij veprimi, përveç fjalisë famoze “mos vdeksh këtu ose mos të vrafsha këtu”, duke mos mundur të sqarohet se A. K. a ka pasur dru, hebëll apo shufër, a e ka goditur duke e ngrë zhag mbi kokën e V. apo duke e tërhequr N. e therrur, apo qëndronte para shkallëve duke shkuar rradhazi të akuzuarit një nga një dhe e kanë goditur, deri sa i ndjeri a ishte vetëm duke qëndruar apo ishte në kontakt me të akuzuarin F. Sh., siç e shpjegon shumica e dëshmitarëve dhe i mbrojturi i tij. Andaj, mbrojtja konsideron se pas analizimit të provave të administruara në këtë çështje penale, gjykatës i propozon që për mbrojturin e tij A. K. që në mungesë të provave të merr aktgjykim lirues për akuzën të cilën e rëndon atë.

Të akuzuarit F. Sh., E. K. dhe A. K. gjatë seancës së shqyrtimit kryesor kanë deklaruar se nuk e pranojnë fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor i ka nxjerr të gjitha provat e domosdoshme dhe pas vlerësimit të secilës prove veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi si dhe duke i marrë parasyshë edhe rekomandimet e Gjykatës së Apelit, ka vërtetur këtë gjendje faktike.

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit F. Sh., E. K. dhe A. K. me datë 02.08.2012 rreth orës 16:30 minuta, ne Suhareke në rrugën “S.”, pikërisht në rrugën përball shtëpive të J. K. dhe N. K., si bashkëkryerës me dashje e privojnë tjetrin nga jeta, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje paraprake në mes të familjes së J. K. dhe I. Sh. në një anë dhe familjes së N. K. në anën tjetër, e në momentin derisa kishte përleshje fizike mes të anëtarëve të këtyre tri familjeve, i akuzuari E. K. pajiset me një hu druri i afrohet të dëmtuarit B. K. i cili në atë moment ishte duke qëndruar përpara shkallëve të shtëpisës tij dhe të njëjtin e godet me atë hu në kokë, e pikërisht në regjionin e veshit të djathtë, pastaj edhe i akuzuari F. Sh. i cili ishte i pajisur me një hu druri të gjatë për afërsisht mbi një metër e godet të dëmtuarin, tani të ndjerin B. K. kokë, pikërisht në tepin e kokës, me ç’rast i dëmtuari fillon të dridhet dhe rrëzohet në tokë duke e humbur vetëdijen, duke qenë ashtu i shtrirë në tokë i pandehuri A. K. i afrohet të dëmtuarit dhe i thotë “nëse nuk të vras këtu kam me të vra në Itali” dhe me një shufër metalike e godet të dëmtuarin, tani të ndjerin B. në kokë, kështu të dëmtuarit tani të ndjerit B. K. i shkaktojnë lëndime trupore si thyerje të ashtit ballor të djathtë, ashtit tamthor të djathtë, ashtit zverkor dhe qatisë së orbitës me dëmtzime të trurit të shoqëruara me gjakderdhje në zona të ndryshme trunore që kanë ardhë si pasojë e thyerjeve të shumfishta të kafkës, i dëmtuari, tani i ndjeri B. K., si pasojë e goditjeve të marra vdes me datë 09.08.2012 në QKUK - Prishtinë.

Per vertetimin e gjendjes faktike gjykata duke i zbatuar edhe rekomandimet e gjykatës së Apelit ka degjuar si deshmitar të dëmtuarat V. K., Z. K., dëshmitarët N. K., Gj. K., dëshmitarët V1. K., S. K., I. Sh., Sh. K., N. K. A. B., H. Z. dhe D. F., me pajtimin e paleve ne pamundesit te sigurimit te prezences se deshmitareve gjykata ka bërë, leximin e dëshmimeve të dëshmitarëve K. K. të dhënë në shqyrtimin gjyësorë të dt.29.07.2013, H. K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dt.22.10.2013, B. K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dhënë me dt.20.11.2013, N. K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë me dt.20.11.2013, Xh. M. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dt.20.11.2013, R. H. të dhënë para PTH-së në Prizren të dt.04.09.2012, Gjykata ka bërë leximin e procesverbalit mbi shikimin e vendit të ngjarjes të dt.23.10.2013, leximin i raportit të autopsisë me nr. MA – 12 – 198 të dt.10.08.2012 i kryer nga eksperti Dr. F. B., leximi i raportit mjekësor i Qendrës Emergjente të Spitalit Rajonal në Prizren me nr. 16515 i dt.02.08.2012 si dhe ekspertiza mjekoligjore të dr. C. M. të dt.08.08.2012, dëgjimin e ekspertëve Dr. C. M., Dr. F. B., ka bërë leximin e superkspertizës mjekoligjore të kryer nga Departamenti i mjekësisë ligjore – nga komisioni profesional, ka bërë dëgjimin e ekspertit mjekoligjor Dr. N. U., ka bërë leximin e raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes nr.2012-GB-596 të dt.03.08.2012, ka bërë shikimin në fotoalbum, leximin e listës së dëshmimeve, ka bërë shikimin në korporadelikt.

I akuzuari F. Sh. gjatë shqyrtimit gjyqësor ne mbrojtjen e tij sikurse ne deklaratën e dhënë pranë prokurorisë dhe ne gjykatë ne shqyrtimin e pare ashtu edhe gjate rigjykimit ka deklaruar se para ngjarjes kritike kishte ardhur në shtëpinë e tyre I. Sh. te cilin e kishte dërguar daja N. respektivisht N. K., ku e kishte porositur që të i thotë babës së tij – I. Sh., që familja e tyre të mos shkon në shtëpi të N. K., lidhur me ardhjen e I. Sh. në shtëpinë e tyre B. pra vëllai i F. nuk ka qenë i njoftuar pasi që kishte qenë në fshatin M. tek miqtë e vet. Më tej ka theksuar se pas 4-5 orëve ishin nisur per në Suharekë, gjegjësisht në familjen e J. pasi që kishin marrë një telefonatë nga kjo familje se po dojnë me e vra B. Sh. djemt e N., të njëjtit nuk po e lejojnë që ai të del prej shtëpisë së J. dhe në atë moment e ka lajmëruar policinë për ngjarjen, ndërsa ai së bashku me babanë e tij I. pas gjysmë ore janë nisur për të shkuar te shikojne se çfarë është duke ndodhur, rrugës janë nisur në këmbë dhe gjatë rrugës e kanë takuar N. K. i cili ishte në rrugë, i njëjti i ka marrë me veturë dhe i ka dërguar deri në shtëpinë e J. K., por të njëjtit janë ndalur 30m larg shtëpisë së N. K. gjegjësisht ka hyrë në

livadhin e J. K. ndërsa babai ishte nisur në drejtim të shtëpisë së N. për të biseduar me të njëjtin, duke shtuar se me të hyrë në livadhin e J. i cili është i rrethuar me rrjete por ka një derë dhe në një moment ka ndëgjuar një bërtimë prej babasë së tij i cili ka thënë “ o më prishën “ dhe me të dalur në rrugë e ka parë babanë e tij të shtrirë dhe të përgjakur, ndërsa afër tij ishin djemtë e N. dhe atë, M., N., B., B., B., F. dhe K., ku M. K. ishte duke goditur me një dru – tram ( land druri ) rreth 50 – 60 cm, F. ka pas një gyp ose dru ngjyrë kafe, B. ka pas një hu rreth 2m ndërsa B. ka pas një shishe birre, ngjarja kishte ndodhur para shtëpisë së J. K. pra në rrugën kryesore. I akuzuari në vazhdim ka theksuar se me tu afruar në vendin e ngjarjes N. e kishte goditur me një letfë të gjatësisë 50 – 60 cm në pjesën e synit të djathtë, pastaj F. e ka goditur me një gyp ku ka rënë në tokë dhe me tu ngritur në këmbë i ndjeri B. duke qenë ballë për ballë me te e ka goditur me një hu rreth 2m të gjatë dhe në trashësi sa dora e tij dhe pasi që është goditur nga B. të njëjtit ia ka marrë hunin dhe e ka goditur të ndjerin B. në pjesën e kokës duke precizuar në mes të kokës dhe në momentin e goditjes i ndjeri ka qenë në këmbë por nuk e ka parë momentin kur është rrëzuar i ndjeri në tokë, dhe në ato momente kishte ardhur policia në vendin e ngjarjes dhe rrahja në kishte përfunduar. Në mes tjerash ka theksuar se momentin kur ka ndodhur përlëshja të akuzuarin E. K. dhe A. K. nuk i kishte parë në vendin e ngjarjes.

Gjykata duke e analizuar mbrojtjen e të akuzuarit F. Sh. fillimisht konstatoi se i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, mirepo edhe për kundër faktit se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë i njëjti në mbrojtjen e tij i ka pranuar veprimet kryesore kur deklaroi se e ka goditur të ndjerin B. me hu në pjesën e kokës duke precizuar në mes të kokës fakt ky qe është vertetur edhe nga deshmite e të gjithë deshmitarve të degjuar si dhe provat materiale të administruara.

I akuzuari E. K. gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tij sikurse në deklaratën e dhënë pranë prokurorisë dhe në gjykatë në shqyrtimin e parë ashtu edhe gjatë rigjyqimit ka deklaruar se ditën kritike ka qenë në shtëpi me vajzën e tij e cila ka pas për tu martuar pas 3-4 ditëve, ndërsa po atë ditë B. Sh. djali dajës ka qenë në shtëpinë e tyre ku me të njëjtin ka ndejtur për një 1 minut pasi që ka qenë i zënë me dasmën e vajzës, ndërsa ai ka vazhduar të qëndrojë me familjarët e tij që kanë qenë në oborr të shtëpisë dhe pas 3-4 minutave ka dëgjuar një zhurmë dhe fjalë të ndyta nga ana e bacit N., duke thënë “ qitni jashtë se kena me mbytë “ por, kur kanë ardhur vëllezërit gjendja është qetësuar për pak minuta dhe i akuzuari kishte shkuar tek vajza e tij Sh. dhe nuk kanë kaluar 30-40 min ka dëgjuar një zhurmë - bërtimë të madhe jashtë dhe ka dal jashtë për shiquar se çfarë është ndodh me vajzën e tij Sh. Po ashtu ka theksuar se ngjarja ka ndodhur para dyerve të shtëpisë gjegjësisht shitores ku ka qenë daja Izet i ranë në gujza i përgjakur krejt dhe po ashtu e ka parë në atë moment F. dhe B. ball për ball me njëri tjetrin ku distanca në mes tij dhe atyre ka qenë 6-7 metra, ndërsa B. ka pas në dorë një shishe ndërsa në dorën e tjetër ka pasur edhe diqka tjetër por nuk ka mund të vëren se çka ka pasur a ka qenë dru apo diqka tjetër të cilën nuk e din. Në vazhdim ka theksuar se në vendin e ngjarjes e ka parë nënën e tij, vëllaun A. duke e tërhequr dajën I. pasi që ka qenë i përgjakur dhe në ato momente është takuar me B. djalin e bacit N. i cili ka qenë me një dru, duke ardhur në drejtim të turmës dhe atë moment e ka kap për dore atë duke u munduar të ndal për të mos shkuar në drejtim tyre, i cili të akuzuarin e kishte kafshuar në anën e majtë të tij, pastaj ai e kishte lëshuar atë dhe me të ngjarja ka përfunduar e cila ka zgjatur rreth 3-4 min. Mes tjerash ka theksuar se kontakti i tij i vetëm ka qenë me B. ndërsa me të tjerët nuk ka pasur asgjë, por i kujtohet se F. ka bërtitë, kur është kthyer prap e ka parë që F. e ka goditur të ndjerin B. në kokë i cili menjëherë ka rënë me kokë në shpinë në tokë – prapa dhe në atë moment nuk ka mundur të vëren se ai është afruar dikush të ndjerit B. pasi që ka pas dhimbje në dorë dhe në atë moment në vendin e ngjarjes ka ardhur policia dhe ka përfunduar e gjithë ngjarja. I akuzuari ka theksuar se të ndjerin B. nuk e ka goditur apo prekur me asnjë mjet pasi që gjatë gjithë kësaj ngjarje nuk ka pas asnjë mjet në dorën e tij, por e ka parë F. që e ka goditur të ndjerin B. vetëm njëherë dhe i njëjti ka mbetë i shtrisë.

Në anën tjetër, në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se sa persona janë arrestuar në vendin e ngjarjes, i njëjti ka theksuar se në vendin e ngjarjes janë arrestuar të gjithë që kanë qenë jashtë respektivisht në vendin e ngjarjes J., A., E., D., A., N., M., N., B., B., F., I., B. dhe F. ndërsa për K. nuk e din.

Gjykata duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit E. K., nuk i kushtoj besim kësaj deklaratë pasi që mbrojtja e këtillë nuk është e pranueshme dhe bindëse për gjykatën dhe se i akuzuari ka për qëllim që ti shmanget përgjegjësisë penale, sepse i akuzuari gjatë tërë procedurës ka mbajtur këtë strategji të mbrojtjes, por këtë fakt i njëjti nuk ka mundur të argumentojë e cila mbrojtje është në kundërshtim me provat materiale, si nga deklaratat e dëshmitarëve V. K., N. K. dhe V. K. të cilët kanë vërtetuar se ditën kritike i akuzuari ka qenë në vendin e ngjarjes i paisur me një dru në dorë me të cilin edhe kishte goditur tani të ndjerin B. në kokë, i cili fakt vërtetohet edhe nga provat materiale si, lista e dëshmive, raporti i autopsisë i kryer nga Departamenti i Mjekësisë, superekspertiza mjekësore, si dhe deklaratimet e ekspertëve në shqyrtimin gjyqësor të cilat konstatojnë se te i ndjeri janë shkaktuar thyerje të shumta në kokë në regjionin djathtë ballor të kokës dhe në regjionin e sinuësëve ballor, mollzor të cilat plagë kanë qenë vdekjeprurëse e të cilat kanë ardhur si goditje të shumta, të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës të cilat në tërësi dëshmojnë të kundërtën me mbrojtjen e të akuzuarit E. K.

I akuzuari A. K. gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tij sikurse në deklaratën e dhënë pranë prokurorisë dhe në gjykatë në shqyrtimin e pare ashtu edhe gjatë rigjyimit ka deklaruar se ditën kritike ka qenë në fshatin P. me bashkëshorten e tij për të marrë një fustan të cilën bashkëshortja e tij e kishte dërguar për të qepur, gjithashtu ka shkuar edhe në fshati Z. për të thirr tre tezet e babës në kanagjeqin e vajzës së vëllaut pra vajzës së E., ndërsa në fshatin S. ka pas për të thirr edhe një kushëri të nënës por të cilës nuk ia ka ditur saktësisht ku e ka shtëpinë dhe ato momente ka thirrur një shokë i tij në telefon për të pirë kafe në qytet dhe në atë moment ka vendos të kthehet në shtëpi ti tregon nënës se nuk ka mund të gjen kushërirën e saj, kur është kthyer në shtëpi në oborr nuk e ka parë askënd, por kur ka shkuar në livadh për të gjetur familjarët e tij në të cilën kanë edhe një shtëpi ka parë nënën, babanë, A., D., S. – grua e A. dhe B. të cilët ishin duke pyetur diçka atë dhe atë moment ka vendos të del jashtë shtëpisë ku ka takuar vajzën e E. të dytën dhe ka hyrë në shtëpi kur rrin zakonisht duke pyetur familjarët e shtëpisë atë se çfarë ka ndodh pasi që nuk ka ditur se çfarë ka ndodhur më herët, ndërsa vajza e E. i kishte thënë se djemt e bacit N. kanë dalur për mbi murrin e tyre dhe kanë dasht të mbysin B. Në vazhdim ka theksuar se pas 7-8 min ka dëgjuar një zhurmë jashtë dyerve të oborrit të shtëpisë, ku ka dal shpejtë të shikon se çfarë është duke ndodhur dhe kur ka dalur jashtë ka parë një tollovi duke u rrahur e shahur me njërin – tjetrin dhe personin e parë që e ka parë ka qenë daja I. që ishte i përgjakur me të ishte edhe nëna dhe vëllai i tij A. të cilët ishin pas shpinës së dajës të cilët duke tërhequr atë, pra në anën e majtë të tij ndërsa përballë dajës I. ka qenë tezja Z. dhe V. të kapur për fyti me dajën I., ku ka dëgjuar tezën Z. duke i thënë djemve të saj “ndihmoni ta ngrehi qenin e plakë, ta shti në podrum dhe ta preje “ dhe atë moment i ka lënë të njëjtit dhe ka ecur përprara dhe në anën e tij të majtë e ka parë të ndjerin B. kurse në anën e djathtë ka qenë F. të cilët kanë qenë duke u kacafytur me fjalë “ o ko me të hangër “ të cilët kanë qenë shumë të nervozuar “ të qartur të dytë “, dhe në atë moment ka shkuar drejt N. dhe F. të cilët ishin duke goditur B., duke u mundur ta tërheqin N. por nuk ka mundur dhe në atë moment ka parë F. ku ka shkuar te daja I. i cili e kishte goditur me një dru dhe atë moment F. e ka kapur mbas shpine dhe e ka tërhequr, ndërsa në atë moment N. i ka thënë “ lëshoje F. “ dhe në ato momente F. i kishte rënë druri prej dorës dhe F. ka ikur në drejtim të B. dhe N. të cilët ishin duke u rrahur në mes veti. Në vazhdim ka theksuar se në ato momente ka ardhur policia dhe kur është kthyer në anën e majtë e ka parë të ndjerin B. i cili ishte i shtrirë në tokë dhe ato momente V. ka bërë titur “ o e mbytën B. “ dhe e njëjta ka shkuar afër tij, por se kush e ka goditur atë dhe nga goditja kujt ka vdekur nuk e dinë. Po ashtu në vendin e ngjarjes nuk e kishte parë të akuzuarin E. por të

njëjtin e ka parë në shtëpi pa përfundimit të ngjarjes. I njëjti po ashtu mes tjerash ka theksuar se druri që ka rënë nga dora e F. në tokë nuk e parë se kushe e marrë dhe vetë ai në ditën kritike nuk ka pas në dorë asnjë mjet të fortë.

Gjykata duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit A. K., dhe pas vlerësimit nuk i kushtoj besim kësaj deklaratë pasi që mbrojtja e këtillë nuk është e pranueshme dhe bindëse për gjykatën, pasi që i akuzuari ka për qëllim që të shmanget nga përgjegjësia penale, sepse i akuzuari gjatë tërë procedurës ka mbajtur këtë strategji të mbrojtjes, por këtë fakt i njëjti prej fillimit të procedurës e deri në përfundim të shqyrtimit kryesor nuk ka mundur të argumentojë me prova materiale dhe e cila është në kundërshtim me prova materiale si deklaratat e dëshmitarëve, Z. K., N. K., Gj. K., dhe pjesërisht nga deklaratat e dëshmitarës V. K., të cilët në mënyrë identike vërtetojnë se i akuzuari ka qenë prezent gjatë përlëshjes në ngjarjen tragjike të ndodhur në ditën kritike i cili e ka goditur të ndjerin B. në kokë, dhe gjatë goditjes të ndjerit i është drejtuar me fjalët “ mos vdeksh këtu të mbysë në Itali”, të cilat fakte vërtetohen edhe nga provat materiale si, lista e dëshmitëve, raporti i autopsisë i kryer nga Departamenti i Mjekësisë, superekspertiza mjekësore, si dhe deklaratimet e ekspertëve në shqyrtimin gjyqësor të cilat konstatojnë se te i ndjeri janë shkaktuar thyerje të shumta në kokë në regjionin djathtë ballor të kokës dhe në regjionin e sinuësëve ballor, mollzor të cilat plagë kanë qenë vdekjeprurëse e të cilat kanë ardhur si goditje të shumta, të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës të cilat në tërësi dëshmojnë të kundërtën me mbrojtjen e të akuzuarit E. K.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë dhe atë, nga leximi i raportit mjekësor i Qendrës Emergjente të Spitalit Rajonal në Prizren me nr. 16515 i dt.02.08.2012 si dhe ekspertiza mjekoligjore të dr. C. M. të dt.08.08.2012, gjykata ka vërtetuar se tani i ndjeri B. K. në ditën kritike ishte pranuar në Qendrën Emergjente në Prizren, me të cilën është konstatuar se i njëjti ka pësuar lëndime trupore e të cilat janë klasifikuar shtypje (mbretje) të shoqëruara me tronditje trunore dhe komë trunore, të përcjellur me gjakëderdhje nën trunore dhe thyerje të kockave të kokës në pjesën ballore dhe thyerje të kockave të hundës, të shkaktuar nga dinamika e veprimit pjesës mbretëse të mjetit të fortë, furishëm sulmues mekanik që përkon me rrethana e çështjes dhe që mund të jenë nga copë druri, hekuri etj, e të cilat i ka kualifikuar lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktueshmërisë.

Lidhur me ekspertizën e kryer gjykata ka dëgjuar ekspertin Dr. C. M. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ka mbetur pranë mendimit të dhënë me shkrim me datë 08.08.2012 i cili mendim ishte bazuar në rrethanat e çështjes, përkatësisht dokumentacionit mjekësorë. Karakteri i lëndimeve kanë ardhur si pasojë e sulmeve dhe lokalizimi i lëndimeve janë përshkruar në kokë respektivisht në regjionin ballor me plagë të kualifikuar si plagë shqyese mbretëse, të cilat kanë qenë të shoqëruara me tronditje trunore, komë trunore e përcjellur gjakëderdhje nëntrunore, thyerje të kockave të kokës në pjesën ballore dhe thyerjeve të kockave të hundës. Mjeti me të cilin janë shkaktuar ka qenë dinamika e veprimit të pjesës mbretëse i mjetit të fortë, furishëm, fuqishëm, sulmues mekanik që ka përkuar në çdo trup që ka peshë dhe furi e fuqi si nga copë druri, hekuri etj.

Nga analizimi i dëshmisë së ekspertit C. M. në shqyrtimin gjyqësor, gjykata ka vërtetuar fakin se lëndimet që i ka pësuar i ndjeri B. në ditën kritike, kanë ardhur si pasojë e sulmeve në kokë, të cilat kanë rezultuar me plagë shqyese dhe të shoqëruar me tronditje trunore dhe gjakëderdhje nëntrunore, thyerje të kockave të kokës dhe të hundës, e të cilat janë shkaktuar nga mjetet të forta si copë druri, hekuri, mjete këto të përshatshme për shkaktimin e lëndimeve trupore e të cilat në rastin konkret kanë rezultuar me vdekjen e tani të ndjerit B.



Nga raporti i autopsisë i kryer nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore nr. MA – 12 – 198 të dt.10.08.2012, është vërtetuar se vdekja e tani të ndjerit B. K., është vdekje e dhunshme, si pasojë e dëmtimit të trurit e shoqëruar me gjakëderdhje në zona të ndryshme trunore, që janë rrjedhojë e thyerjeve të shumta të kafkës nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë).

Eksperti Dr. F. B. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka mbetur në tërësi pranë mendimit dhe konstatimit të dhënë me shkrim në raportin e autopsisë si dhe në deklarinimin e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësorë të mëparshëm të datës 23.10.2013, ndërsa në shqyrtim kryesor ka deklaruar se plagët vdekje prurëse të cilat janë shkaktuar të ndjerit në ditën kritike kanë qenë në regjionin ballor të djathtë të kokës 10 cm mbi vetull të djathtë dhe rreth 1 cm nga vija e mesme e kokës, ku ka konstatuar vrazhën ose cikatriskin e qepur gjatë trajtimit mjekësorë duke theksuar se kjo ka qenë plagë shqyese e shkaktuar me mjete të forta ose të topitura, ndërsa plagë të tjera nuk janë konstatuar, ku ka hematoma, gërvishtje por jo edhe plagë. Në vazhdim ka sqaruar se prej këtyre plagëve që i ka pësuar i ndjeri plagë vdekjeprurëse kanë qenë në regjionin ballor të kokës të shoqëruar me thyerje zhytëse të kockave ballore si dhe me dëmtimin e trurit në zonat përkatëse e që është dëmtim masiv me karakter vdekjeprurës, ndërsa sa i përket frakturës apo thyerjes së bazës së kafkës nuk ka përjashtuar mundësinë që ka qenë faktorë kontribues në ardhjen e vdekjes por ka theksuar se kjo është e padiskutueshme pasi që është dëmtim të strukturave trunore, dëmtim në hundë e përcjellur me thyerje të kockave të hundës dhe sinusit maksillar e që nuk e prek indin trunor sepse ajo është jashtë trurit e si e tillë nuk ka qenë vdekjeprurës, po ashtu edhe hematomat në anën e majtë nuk kanë qenë vdekjeprurëse, e të gjitha këto plagë kanë ardhur si pasojë e shumë e goditjeve. Më tej eksperti ka sqaruar se si pasojë e thyerjeve të ashtit ballor të anës së djathtë është pasojë e një goditje në këtë zone sepse e njëjta është shoqëruar me zhytje të fragmenteve në indin trunor dhe në momentin e kësaj goditje, nuk ka përjashtuar mundësinë se pas goditjeve të kësaj natyre që për disa sekonda të ketë qëndruar në këmbë.

Nga analizimi i ekspertit Dr. F. B., gjykata ka vërtetuar se plagët vdekje prurëse të cilat janë shkaktuar të ndjerit në ditën kritike kanë qenë në regjionin ballor të djathtë të kokës 10 cm mbi vetull të djathtë dhe rreth 1 cm nga vija e mesme e kokës, e cila plagë shqyese është shkaktuar me mjete të forta ose të topitura. Plagët vdekjeprurëse të i ndjeri kanë qenë në regjionin ballor të kokës të shoqëruar me thyerje zhytëse të kockave ballore si dhe me dëmtimin e trurit në zonat përkatëse e që është dëmtim masiv me karakter vdekjeprurës, ndërsa lidhur me thyerjet e së bazës së kafkës të njëjtat kanë kontribuar në ardhjen e vdekjes, të cilat plagë të i ndjeri janë shkaktuar si pasojë e shumë goditjeve.

Nga leximi i superkspertizës mjekoligjore të kryer nga Departamenti i mjekësisë ligjore – nga komisioni profesional, gjykata ka vërtetuar se komisini nga ekspertët mjekoligjor të Departamentit të Mjekësisë Ligjore në përbërje të ekspertëve prej Dr. N. U., Dr. F. D. dhe Dr. V. K., kanë dhënë konkluzionin bazuar në raportin e autopsisë dhe në përshkrimin e plagëve të raporteve mjekësore të spitalit rajonal të Prizrenit dhe QKUK – Klinikës së Anesteziologjisë dhe mjekimit intensiv, kanë konkluduar me besueshmëri të lartë shkencore se gjendja e të ndjerit B. K. nga pranimi e deri vdekje, sipas raporteve mjekësore të spitalit të Prizrenit dhe QKUK-së, ka qenë gjendje komatoze dhe e pavetëdijshme. Plagët vdekjeprurëse konsistojnë me plagë – thyerje në regjionin ballor të kokës dhe thyerjet e sinusve ballor, mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë. Ndërsa, shkaku i vdekjes në rastin konkret ka qenë gjakëderdhja e brendshme trunore e cila është rrjedhojë e thyerjeve të shumfishta të kockave të kafkës dhe bazës së kafkës. Në vazhdim kanë theksuar se mjetet me të cilat është goditur tani i ndjeri konsistojnë në mekanizmin në veprimin e mjeteve të forta mbretëse, pa maje dhe jo të prehta.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit – ekspertit mjekoligjor Dr. N. U., i cili ka qëndruar pranë superekspertizës të datës 07.07.2015 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se tek i ndjeri janë shkaktuar thyerje të shumta të cilat thyerjet kanë të bëjnë me thyerje në regjionin e djathtë ballor të kokës, thyerjet e sinusve ballor mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë, si dhe plagët e shumta në pjesët në të cilat janë evidentuar thyerjet. Në vazhdim ka sqaruar se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy grupe plagësh vdekjeprurëse të cilat janë konstatuara si thyerje në regjionin e djathtë ballor të kokës dhe grupi tjetër i plagëve të shumfishta në regjionin e sinuseve ballor, mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë, të cilat plagë janë të lokalizuara në regjionin e djathtë ballor dhe sinusal të kokës dhe fytyrës. Po ashtu ka sqaruar se thyerjet e shumfishta të kockave ballore e ka përshkruar në grupin e plagëve vdekjeprurëse, duke mos e cilësuar ose klasifikuar se a ka qenë zhytëse apo jo, pasi që është plagë vdekjeprurëse. Po ashtu ka potencuar se në konkluzionet e tyre kanë pasur për bazë jo vetëm raportin e autopsisë, por janë marrë në konsiderim edhe raportet tjera mjekësore në përshkrimin e plagëve dhe sqarimin e tyre, në përshkrimin e dëmtimit të freskëta në raportin e autopsisë në faqen 3, ku janë dhënë detaje me përngjyrimë dhe karakteristika të tjera të plagëve si rezultat i trajtimit mjekësorë. Më tej në vazhdim eksperti ka sqarur lidhur me bazën e kafkës, ku gjatë procedurës së autopsisë kocka e kafkës prehet në mënyrë horizontale përmbi regjionin e veshëve duke shkuar përpara nëpër regjionin ballor dhe pas në regjionin e pasëm të kokës në formë të rrethit të plotë, me atë rast hapet pjesa e sipërme e kokës, heqet indi truror dhe me atë rast paraqitet pjesa e mesme të kafkës e cila paraqet bazën e kafkës.

Nga dëgjimi i ekspertit mjeko ligjor N. U., gjykata ka vërtetuar se te i ndjeri në ditën kritike janë shkaktuar thyerje të shumta në regjionin e djathtë ballor të kokës, thyerjet e sinusve ballor mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë, si dhe plagët e shumta në pjesët në të cilat janë evidentuar thyerjet. Në rastin konkret kemi të bëjmë me dy grupe të plagëve vdekjeprurëse të cilat si thyerje në regjionin e djathtë ballor të kokës dhe grupi tjetër i plagëve të shumfishta në regjionin e sinuseve ballor, mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë, të cilat plagë janë të lokalizuara në regjionin e djathtë ballor dhe sinusal të kokës dhe fytyrës, e të cilat thyerje të shumfishta e të cilat janë konstatuara në kockat ballore kanë qenë plagë vdekjeprurëse. Pra në rastin konkret eksperti sikurse në ekspertizën me shkrim ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor plagët të cilat i ka marrë i ndjeri B. ditën kritike, i ka përcaktuar si gy grupe plagësh, të përshkruara si më lartë, Po ashtu ka thyerjet e shumfishta të kockave ballore i ka përshkruar në grupin e plagëve vdekjeprurëse, duke mos i cilësuar ose klasifikuar se a ka qenë zhytëse apo jo, pasi që është plagë vdekjeprurëse.

Nga analizimi i provave mjekësore ne rastin konkret gjykata ka vërtetuar se tani i ndjeri B. K. ditën kritike me date 02.08.2012 ishte pranuar në Qendrën Emergjente në Prizren, ku është konstatuar se i njëjti ka pësuar lëndime trupore e të cilat janë klasifikuar shtypje (mbretje) të shoqëruara me tronditje trunore dhe komë trunore, të përcjellur me gjakëderdhje nën trunore dhe thyerje të kockave të kokës në pjesën ballore dhe thyerje të kockave të hundës, i njëjti te njëjten dite është transferuar ne QKUK ne Prishtine ku i është nenshtuar trajtimit mjekësore deri me daten 09.08.2012, kur pasi qe nuk mund ti mbijetoj plageve vdes. Autopsia e te njëjtit behet me date 10.08.2012 ku është vërtetuar se vdekja e tani të ndjerit B. K. është vdekje e dhunshme, si pasojë e dëmtimit të trurit e shoqëruar me gjakëderdhje në zona të ndryshme trunore, që janë rrjedhojë e thyerjeve të shumta të kafkës. Pert te vereteuar shkaku e vdekjes gjykata ka urdheruar qe te kryhet superekspertiza nga komisioni profesional prane Departamentit te mjekësisë ligjore te cilet ne superekspertizen e kryer konstatojne se gjendja e të ndjerit B. K. nga pranimi e deri vdekje, sipas raporteve mjekësore të spitalit të Prizrenit dhe QKUK-së, ka qenë gjendje komatoze dhe e pavetëdijshme. Plagët vdekjeprurëse konsistojnë me plagë – thyerje në regjionin ballor të kokës dhe thyerjet e sinusve ballor, mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë. Ndërsa, shkaku i vdekjes në rastin konkret ka qenë gjakderdhja e brendshme trurorë e cila është rrjedhojë e thyerjeve të shumfishta të kockave të kafkës dhe bazës së kafkës. Mjetet me të cilat është goditur tani i ndjeri konsistojnë në

mekanizmin në veprimin e mjeteve të forta mbretëse, pa maje dhe jo të prehta. Lidhur me konstatimet e bera në superekspertizë eksperti mjekoligjor Dr. N. U. ka sqaruar se tek i ndjeri janë shkaktuar thyerje të shumta të cilat thyerjet kanë të bëjnë me thyerje në regjionin e djathtë ballor të kokës, thyerjet e sinusve ballor mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë, si dhe plagët e shumta në pjesët në të cilat janë evidentuar thyerjet, ka sqaruar se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy grupe plagësh vdekjeprurëse të cilat janë konstatuara si thyerje në regjionin e djathtë ballor të kokës dhe grupi tjetër i plagëve të shumfishta në regjionin e sinuseve ballor, mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë, të cilat plagë janë të lokalizuara në regjionin e djathtë ballor dhe sinusal të kokës dhe fytyrës. Thyerjet e shumfishta të kockave ballore i ka përshkruar në grupin e plagëve vdekjeprurëse, duke mos e cilësuar ose klasifikuar se a ka qenë zhytëse apo jo, pasi që është plagë vdekjeprurëse.

Sa i përket plagëve vdekjeprurëse gjykata nga te lartecukurat konstatoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy grupe plagësh vdekjeprurëse, pra nuk është vetëm njera plagë vdekjeprurëse por disa plagë që superekspertiza i klasifikon si dy grupe plagësh vdekjeprurëse të cilat plagë konsistojnë në thyerje në regjionin e djathtë ballor të kokës dhe grupi tjetër i plagëve të shumfishta në regjionin e sinuseve ballor, mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë, të cilat plagë janë të lokalizuara në regjionin e djathtë ballor dhe sinusal të kokës dhe fytyrës. Sa i përket "plages zhytëse" superekspertiza nuk e karakterizon si të tillë por vetëm e përcakton si njera nga plagët vdekjeprurëse.

Nga leximi i raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes nr.2012-GB-596 të dt.03.08.2012, është vërtetuar ngjarja ka ndodhur me datën 02.08.2012 rreth orës 16:30 min, në rr. " S. " në Suharekë para shtëpive të N. K. dhe J. K. dhe pjesëmarrës tjerë kanë qenë I. Sh., F. Sh., B. Sh., J. K., E. K., A. K., E. K., D. K., M. K., F. K. dhe N. K.

Nga shikimi i fotoalbumit, vërtetohet vendi ku ka ndodhur ngjarja tragjike, ku shihen shtëpitë e N. K. dhe J. K. të cilat i ndane vetëm një mur shihet edhe lokali para të cilit është zhvilluar ngjarja ditën kritike si dhe dhe mjetet të cilat janë përdorur gjatë përleshjes si hujë, çekan, kubëza betoni e fshisë.

Nga lista e dëshmive, vërtetohet se nga vendi i ngjarjes janë konfiskuar si: një çekan i ngjyrës së zezë, një shishe plastike me njolla gjaku, një fshisë me bishte të gjatë, një fshisë me ngjyrë të zezë, një cop druri, dy cop druri të bishtit të fshisë, një dru rreth 2 metra i gjatë, një dru rreth 1.5 m i gjatë, një dru rreth 80 cm i gjatë, një shami për femra dhe pesë telefona mobil.

Gjendjen e këtyre faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitares V. K. e cila në dëshminë e saj sikurse në prokurori dhe në shqyrtimet e mëparshme ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ka theksuar se të ndjerin B. e ka pas bashkëshort dhe me të njëjtin ka një djal me emrin D. E njëjta ka shtuar se një ditë para se me ndodh rasti në ditën kritike kanë pasur dasmë me rastin e martesës së kunatit të saj K., dhe në ditën kritike ka qenë në shtëpi duke pastruar, fillimisht nuk ka dëgjuar fillimin e ngjarjes pasi e ka pasur muzikën e lëshuar, mirëpo më vonë rastësisht ka dëgjuar një zhurmë (bërtimë) dhe ka dal jashtë, ku e ka parë kunatin e saj M. të gjakosur në fytyrë, po ashtu e ka parë edhe B. – kunatin i cili e ka pasur maicën e grisur dhe me të vërejt këtë ngjarje ka vrapuar drejt derës së jashtme të shtëpisë për të parë se çka është duke ndodhur jashtë shtëpisë dhe në atë moment ka parë të tre familjet duke u përlesh mes veti. Në ato momente shton se i ka shkuar në mendje burri i saj B. të cilin e ka parë në turmë duke qëndruar në anën e rrugës në këmbë, në atë moment ka dashtur që bashkëshortin ta tërheq nga vendi i përleshjes, e në atë moment e ka parë J. K. i cili ka dalur nga shtëpia e tij me një çekan të madh me një bisht të shkurtër të cilën e mbante në dorë, ku i njëjti ka shkuar në drejtim të B. të cilin e ka goditur në kokë, por në cilën pjesë e ka goditur nuk i kujtohet, në ato momente dikush e ka tërhequr mprapa por kush nuk i kujtohet duke i

thënë se “ nuk guxon të del jashtë dhe duke e futur brenda në shtëpi “ dhe ato momente është alivanosur dhe pasi është këndellur në ato momente i ka shkuar në mendje djali i saj të cilin e ka pas bashkëshorti në dorë, me të cilin fillimisht bashkëshorti me djalin ka qëndruar në podrum, por pasi ka vepruar drejt shkallëve e ka parë djalin i cili ka qenë duke qëndruar te shkallët e podrumit dhe në një moment e ka marrë djalin dhe ia ka dhanë dikujt në dorë dhe prap ka vrapuar për të dalur jashtë te dera dhe ka parë vjehrrin N. i cili ishte duke qëndruar dhe i heshtur ku kishte kapur duart e kapur në kokë. Po ashtu ka potencuar se i ka parë familjarët e J., A. K. me bashkëshorten e vet si dhe E. K. i cili mbante në dorë dru apo shufër, ndoshta ka qenë edhe dru por saktë nuk i kujtohet por i kujtohet që ka qenë një send i gjatë, i cili e ka goditur B. një herë në pjesën e epërme të kokës i cili qëndronte në ato momente në mesin e turmës. Thekson se pas goditjes nuk ka parë më çfarë ka ndodhur. Ndërsa në përlëshje ka parë A. i cili ka qenë me bashkëshorten e tij si dhe F., por veprimet e tyre nuk ka mund ti vëren. Po ashtu ka theksuar se para se të godit E. K. të ndjerin B. dëshmitarja B. e kishte parë të gjakosur nga goditja e J. K.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitares V. K., gjykata në tërësi ia ka fal besimin deklaratës së kësaj dëshmitare, pasi që dëshmitarja ka përshkruar dhe treguar në tërësi situatën që ka ndodhur në ditën kritike dhe e cila deklaratë është në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve si dhe me provat materiale. Nga dëshmia e kesaj dëshmitare gjykata ka vërtetuar se e njëjta të ndjerin B. e ka pas bashkëshort dhe nga kjo martesë ka një djalë me emrin D., se një ditë para ditës kritike në familjen e tyre kanë pasur darsëm ku është martuar kunati i saj K. Se para se të ndodh ngjarja tragjike e njëjta ka qenë në shtëpi duke pastruar, ndërsa B. me djalin tij në podrum të shtëpisë, në një moment ka dëgjuar një zhurmë dhe ka dalur jashtë, ku ka vërejtur kunatin saj M. të gjakosur në fytyrë si dhe B. e ka parë i cili e kishte pas maicën e grisur. Se gjatë përlëshjes në mesin e turmës ka parë të ndjerin B. i cili ishte në mes turmës dhe në këtë turmë kanë qenë edhe J. K., E. K., A. K. me bashkëshorten e tij dhe F. Sh. Se J. K. i cili kishte dalur nga shtëpia e tij me një çekan në dorë fillimisht e kishte goditur të ndjerin B. në kokë i cili nga kjo goditje kishte gjakosur. Po ashtu nga kjo deklaratë vërtetohet se pas goditjes së J., E. K. e kishte goditur një herë të ndjerin B. me një mjet të fortë të gjatë e cila nuk ka mund të përshkruan saktë se a ka qenë hujë apo hekur, për shkak të gjendjes së rëndë psiçiko-fiziko në momentin kur e ka parë bashkëshortin e saj i cili po në mes turmës dhe i gjakosur andaj edhe nuk ka mund ta përshkruan mjetin me të cilin është goditur i ndjeri B. nga i akuzuari E.

E dëmtuara Z. K. e cila është dëgjuar si dëshmitare gjatë shqyrtimit kryesorë ka deklaruar sikurse në deklaratën e saj të dhënë në prokurori 26.09.2012 dhe në shqyrtimet e mëparshme të dt.25.04.2013, duke shtuar se një ditë para ngjarjes kritike kanë pasur darsëm në shtëpinë e tyre, në ditën e darsmës kanë shkuar për të marrur nuse dhe po atë ditë i akuzuari F. Sh. e ka parkuar veturën para dyerve të shtëpisë së tyre si dhe të familjes J. K. kishin parkuar veturën para një shtylle me qëllim që të pengojnë në shkuarjen e marrjes së nusës, në këtë rast burri i saj duke e parë këtë provokim ka shkuar te I. Sh. nga i cili ka kërkuar që të shkoj te I. Sh. me një porosi duke i thënë “ a bon me shku te I. me i thanë vëllavi vëllaut i ka dyert afër meje po ty çka të bona që ma qet kerrin te dera “. Ndërsa sa i përket ditës kritike dëshmitarja ka theksuar se të tre të akuzuarit kanë pasur mjete të forta për goditje, më sa i kujtohet E. ka pasur një hekur në dorë, A. po ashtu ka pasur hekur ndërsa F. ka pasur një dru të trashë duke përshkruar si një dru i trashë. E njëjta ka theksuar se e ka parë F. në shtëpinë e tyre afër podrumit i cili ka pasur në dorë një dru të trashë me të cilin e ka goditur B. në kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit. Më tej ka theksuar se B. ka qenë në këmbë në momentin kur e ka marrë goditjen nga ana e F., ndërsa E. i ka sjellë me një hekur i cili ka qenë në formë të shipkës me të cilin e ka goditur B. në kokë, po ashtu edhe A. e ka parë i cili në ato momente me një dru në dorë e ka goditur B. sa ka mundur në kokë, në hundë, dhe në pjesët e tjera ku ka mundur dhe në një moment A. i ka thënë me fjalë “ mos vdeksh këtu të mbysë në Itali “, dhe pasi që e është rrëzuar B., personat e lartcekur kanë ikur nga vendi i ngjarjes dhe janë veshur me tesha të reja.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitares Z. K., gjykata ka vërtetuar se dëshmitarja të ndjerin B. e ka djalë ndërsa N. e ka bashkëshort, se një ditë para ditës kritike në familjen e tyre kanë pasur darsëm ku është martuar djali i saj K., po atë ditë kanë pasur provokime nga ana e akuzuarit F. Sh. dhe të familjes J. K. të cilët kishin parkuar veturat e tyre pranë shtëpisë së N. me qëllim të pengimit për shkuarjen e marrjes së nusës. Në ditën kritike është vërtetuar se të tre akuzuarit F. Sh., E. K. dhe A. K. kanë qenë të paisur me mjete të forta për goditje. Se të ndjerin B. së pari e ka goditur i akuzuari F. Sh. me një dru të trashë të cilin e ka godit në kokë dhe nga ajo goditje i ndjeri B. ka qenë në këmbë, ndërsa goditjet ndaj të ndjerit B. kanë vazhduar e E. K. i cili ka pasur hekur – shipkë të gjatë me të cilin e ka goditur të ndjerin në kokë si dhe i akuzuari A. K. ka qenë i paisur me një dru në dorë me të cilin e ka goditur në kokë, hundë dhe pjesë tjera të trupit dhe duke i thënë me fjalë të ndjerit “ mos vdeksh këtu të mbysë në Itali “. Gjykata edhe kësaj dëshmie në tërësi ia ka fal besimin deklaratës së kësaj dëshmitare, pasi që dëshmitarja ka përshkruar dhe treguar në tërësi situatën që ka ndodhur në ditën kritike, e cila përshkruan veprimet e ndërmarra te secilit akuzuar në ditën kritike ndaj të ndjerit B. e cila deklaratë është në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve si dhe ka mbështetje edhe ne provat materiale.

Gjendjen faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit N. K. i cili gjatë shqyrtimit kryesor ka theksuar se para ditës kritike kanë pasur darsëm, në të cilën kanë qenë të ftuar I. dhe J., por të njëjtit nuk kishin ardhur në darsëm, edhe për kundër asaj të njëjtit në ditën e darsmës kanë bërë provokime, duke i parkuar automjetet përpara shtëpisë së tyre për ta pamundësuar ardhjen e nuses. Dëshmitari më tej ka theksuar për të qetësuar këtë gjendje, në mëngjesin e ditës kritike ka dërguar I. Sh. tek I. Sh. duke kërkuar nga i njëjti që të mos bën përçarje në mes të vëllezërve, të cilën porosi I. Sh. ia kishte përcjellë. Por situata ndërmejt familjeve nuk ishte qetësuar pasi që B. po atë ditë kishte ardhur në shtëpinë e J. duke i mshuar dyerve të oborrit të shtëpisë së tij, dhe djemtë e tij i kishin thënë “ si u bo babë ti i qove njerëz atyre ata erdhën prap na provokuan “ dhe gjatë kësaj kohe edhe djemtë e tij dhe të atyre kanë qenë duke bërtit se përse është ardh B. dhe të njëjtit kishin filluar të i provokonin fëmijët e dëshmitarit, por situata në ato momente ishte qetësuar, por në momentin kur në vendin e ngjarjes kishin ardhur I. dhe F., së bashku më 9 veta të tjerë të familjes së J. në shtëpinë e tyre, gjegjësisht në lokalën i cili është në oborr të shtëpisë, ndërsa djemt e tij ka në qenë 6 veta. Në atë moment dëshmitari thekson se ka qenë me djalin e tij B. në podrum dhe në oborr ka dëgjuar një zhurmë dhe pasi që ka dalur jashtë me B. ka parë të gjithë të përgjakur, së pari J. e kishte parë me një çekiç në dorë, ndërsa M. (djali i tij) ishte gjakosur. Në vazhdim thekson se B. pasi që ka dal nga podrumi ka filluar të tërheq N. i cili në ato momente kishte qenë i therur me thikë në bark nga ana e E. dhe në atë momente B. së pari e kishte goditur F. në kokë me një hu 1,5m i cili pas goditjes ka qëndruar në këmbë, pastaj E. me një hujë në gjatësi prej 1.5 m duke e goditur në anën e djathtë të kokës ndërsa A. ka goditur me hebël në ballë dhe hundë, ku secili i ka goditur B. me nga dy-tre goditje.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitarit N. K., gjykata ka vërtetuar se dëshmitari të ndjerin B. e ka djalë, se një ditë para ditës kritike në shtëpitë kanë pasur darsëm ku e kanë martuar djalin e tyre K., në të cilën kanë qenë ftuar edhe J. K. dhe I. Sh. por të cilët nuk kishin ardhur edhe përkundër ftesës, por të njëjtit kanë vazhduar me provokime duke i parkuar para shtëpisës me qëllim të pengimit të marrjes së nusës, duke parë këtë situatë para ngjarjes kritike të nesërmen ka dërguar I. Sh. tia dërgojë porosi I. Sh. me qëllim qetësimit të situatës, mirëpo përkundër kësaj nuk ishte qetësuar, pasi që B. po atë ditë para ngjarjes kishte ardhur në shtëpinë e J. duke e goditur dyert e shtëpisë, ku djemtë e N. i kanë thënë babait të tyre se “ si u bo babë ti i qove njerëz atyre ata erdhën prap na provokuan “. Mirëpo situata ishte e keqësuar me ardhjen e I. dhe F., ku të njëjtit kishin filluar të sulmojnë djemtë e N., ndërsa në ato momente N. me të ndjerin B. kishin qenë në podrum dhe me të dëgjuar një zhurmë kanë dalur nga podrumi jashtë, ku e kanë parë të gjakosur djalin M. si

dhe N. e duke parë këtë gjendjen i ndjeri B. ishte afruar ti ndihmojë vllaut të tij N. duke tërhequr i cili ishte i therrur e në ato momente i akuzuari F. i cili ishte i paisur me një hu druri në gjatësi prej 1.5 m e godet në kokë të ndjerin B. i cili edhe përkundër goditjes ka qëndruar në këmbë, goditjet ndaj të ndjerit kanë vazhduar nga ana e akuzuarit E. i cili po ashtu i paisur me një hu druri në gjatë prej 1.5 m duke e goditur të ndjerin në anën e djathtë të kokës e po ashtu këto goditje kanë vazhduar edhe nga ana e të akuzuarit A. i cili ka qenë i paisur me një hebëll duke e goditur të ndjerin në ballë dhe hundë. Gjykata edhe kësaj dëshmie në tërësi ia ka fal besimin deklaratës së këtij dëshmitari, pasi që dëshmitari në tërësi ka përshkruar dhe treguar veprimet e secilit të akuzuar që janë ndërmarrë ndaj të ndjerit B. dhe mjetet me të cilat ata kanë pasur në ditën kritike e të cilat veprime përputhen edhe nga deklaratat e dëshmitareve V. K., Z. K. si dhe me provat materiale nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nr.2012-GB-596 të dt.03.08.2012, në fotoalbumin, listës së dëshmimeve si dhe në korporadelikt e të cilat prova materiale gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares Xh. K., e cila sikurse në dëshminë e saj të dhënë para prokurorit si dhe në shqyrtimin e parë gjyqësor ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se para ditës kritike kanë pasur darsëm ndërsa ditën kritike ka qenë ditë e grave dhe pasi që i kanë përcjellur vajzat të cilat kanë sjellur lule për nusen, të gjithë grat janë shpërndar nëpër dhoma për ti vënë fëmijët në gjumë dhe ka dëgjuar një bërtimë - zhurmë që vinte nga jashtë, pas kësaj ka marrë djalin dhe ka dal jashtë te dera në oborr, ku ka ndëgjuar edhe më shumë zhurmë, por kur ka dal jashtë shtëpisë gjegjësisht para shitores e cila ndodhej te dera e shtëpisë, e ka parë J. me djemtë e tij dhe të rejat me nipa e mbesa si dhe I. me dy djemtë e tij B. e F. Fillimisht e ka pa J. me një çekiq në dorë i cili e ka goditur të ndjerin B., ndërsa E. ka qenë me një hekër në dorë duke e goditur B. në kokë, F. ka pas në dorë një dru me të cilin e ka goditur B. në kokë dhe F. me B. kanë qenë shumë afër njëri – tjetrit ndërsa dëshmitarja në momentin e goditjes ka qenë 3 – 4 metra larg dhe po ashtu edhe A. i cili ka pas në dorë një dru të trashë duke e goditur B. në kokë dhe pasi që ka ra në tokë të ndjerit B. i është drejtuar me fjalët “ mos të mbytsa këtu ka me të mbytë në Itali “. Dëshmitari ka precizuar se i ndjeri B. është rrëzuar në tokë nga goditja e A., ku i ndjeri B. ka rrotulluar sytë dhe ka ra në tokë. Dëshmitarja në vazhdim ka theksuar se goditjet e J., F. e A. të cilët e kanë goditur të ndjerin B. goditjet e tyre kanë qenë të njëpasnjëshme respektivisht nuk kanë qenë të gjitha menjëherë.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitares Xh. K., gjykata ia ka fal besimin deklaratës së kësaj dëshmitare, pasi që dëshmitarja ka përshkruar dhe treguar në tërësi situatën që ka ndodhur në ditën kritike, e cila ka shkjaruar veprimet e ndërmarra të secilit të akuzuar veç e veç dhe goditjet e të akuzuarve drejtuar të ndjerit kanë qenë të shumta dhe të njëpasnjëshme. E cila deklaratë është në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve Z. K., N. K., V. K. si dhe me provat materiale nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nr.2012-GB-596 të dt.03.08.2012, në fotoalbumin, listës së dëshmimeve si dhe në korporadelikt e të cilat prova materiale gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares V. K. e cila sikurse në deklaratën e dhënë para prokurorit ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se shkaku i ngjarjes ka qenë B. Sh. dhe I. Sh., pasi që babai i saj me datë 01.08.2012 i ka dërguar fjalë I. Sh. për të mos ardhur me B., mirëpo ditën kritike B. ka ardhur prap i cili ka kërcënuar duke goditur dyert e shtëpisë. Në ditën kritike J. me djemtë e tij kanë qenë të paisur me mjete të forta thikë, çekiq, hekur dhe dru. J. ka pasur një çekiq në dorë i cili edhe e ka goditur vëllaut të tij B. në pjesën e djathtë afër syrit, F. ka pas një dru të madh të trash por nuk e ka parë të njëjtin duke e goditur B. pasi që atë moment ka qenë duke i ndihmuar nënës së saj, ndërsa E. ka pasur në dorë një dru me të cilën e ka godit B. në kokë ka veshi dhe A. pasi është rrëzuar B. në tokë e ka godit në pjesën ka hunda në ballë, ku edhe në të njëjtën kohë e ka goditur edhe dëshmitaren. A. në momentin kur është rrëzuar B. në tokë i është drejtuar me fjalët “ mos vdeksh këtu ka me tmbytë në Itali “. Po e njëjta në vazhdim ka theksuar se gjatë tërë kohës së

ngjarjes tragjike ka qenë jashtë shtëpisë së saj dhe ka parë tërë ngjarjen e cila ngjarje përafërisht ka ndodhur prej 3 deri 7 minuta.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitares V. K., gjykata ka vërtetuar se të ndjerin e ka vëlla, se ditën kritike e ka parë në vendin e ngjarjes J. me djemtë e tij të cilët kanë qenë të paisur mjete të forta thikë, çekan, hekur dhe dru, se J. kishte pasur në dorë një çekiç me të cilin mjet e kishte goditur të ndjerin B. në pjesën e djathtë afër syrit, po ashtu e ka parë edhe F. i cili me një dru të trash por nuk e ka parë që e ka goditur vëllaun e saj B., ndërsa e ka vërejtur se E. me një dru të trash e kishte goditur B. në kokë në afërsi të veshit si dhe A. pasi që i ndjeri B. ka rënë në tokë, i njëjti e ka goditur në pjesën ka hunda dhe ballë por mjetin me të cilin e ka goditur nuk e ka vërejtur se çfarë ka pasur në dorë por në ato momente ka dëgjuar nga A. i cili ishte drejtuar B. me fjalë “ mos vdeksh këtu ka me tmbytë në Itali “ dhe se e tërë ngjara ka ndodhur përafërsisht prej 3 deri 7 minuta. Po ashtu gjykata edhe kësaj dëshmitare ia ka fali besimin në tërësi, pasi që deklarata e saj është bindëse, argumentuese dhe identike me deklaratat e dëshmitarëve Z. K., N. K., V. K. dhe Gj. K. me të cilat ka treguar veprimet e ndërmarra nga ana e të akuzuarve F. Sh., E. dhe A. K., e të cilat janë në harmoni me provat materiale si raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nr.2012-GB-596 të dt.03.08.2012, në fotoalbumin, listës së dëshmimeve si dhe në korporadelikt e të cilat prova gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares S. K. e njëjta gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka dëshmuar se B. e ka babë, A. e E. i ka kunat ndërsa F. e ka dajë të burrit. E njëjta ka përshtuar se ngjarja kritike kishte ndodhur afër shtëpisë së N. dhe të J., duke theksuar se F. ka pasur në dorë një shatë – hekur me të cilën e ka goditur B. një herë i cili edhe kishte rënë në tokë. Përveq V. dhe dëshmitares askush tjetër nuk ishte afruar afër B., në anën tjetër E. ishte me B., B. kishte pasur në dorë një dru, të cilit E. ishte duke i thënë që të lëshoj drurin ndërsa B. e kishte kafshuar në krah E. F e kishte pasur në dorë një shat me qyk të prehtë, prej F. dëshmitarja kishte parë vetëm një goditje ku B. kishte rënë në tokë, dëshmitarja tërë kohën kishte qenë në ngjarje dhe nuk e kishte parë se dikush tjetër e kishte goditur B. edhe pasi që kishte rënë në tokë i ndjeri B., i cili kishte qenë shumë afër dëshmitares në momentin kur kishte rënë në tokë. E. atë ditë ishte me B. në anën e kundërt të B. dhe të dëshmitares, E. nuk ishte afruar afër B. përveq V. dhe vet dëshmitares, ndërsa A. kishte qenë në ngjarje dhe i habitur me atë që po ndodhte sepse ai kishte ardhur në atë moment kur ndodhej përlëshja. Dëshmitarja shtonë se në atë rrëmujë kishte qenë deri sa e kishte gjetur djalin e saj dhe se bashku me djalin kishin hyrë mbrenda, ku dhe e kishte dëgjuar ardhjen e policisë.

Duke analizuar deklaratën e dëshmitares S. K. gjykata pjesërisht ia fali besimin kësaj deklaratë dhe atë vetëm aty ku e njëjta deklaroi se e kishte parë F. kur e ka goditur B. dhe i njëjti kishte ra në tokë, mirëpo pjesës tjetër të deklaratës së saj nuk ia fali besimin pasi që është në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarve tjerë dhe provav e materiale të kësaj çështje penale.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit I. Sh., i njëjti sikurse në dëshmine e tij të dhënë në prokurori ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se para ngjarjes kritike N. e kishte takuar dëshmitarin dhe e kishte lutur atë që të shkonte në fshatin P. tek një kushëri i tij me emrin I. për t'ia përcjellë porosin lidhur me provokimet e I. rreth parkimit të veturave në shtëpinë e tij. Në vazhdim ka sqaruar se kishte pranuar të shkonte tek I. dhe t'ia përcjellë porosin e të cili e ka dërguar me veturë djali i N., më pas i njëjti ka hyrë në shtëpi ku I. ia ka përcjellë porosinë e N. duke i thënë “ që të mos parkon veturat para shtëpisë së N. “ ndërsa I. i është përgjigjur me fjalët “ na i rregullojmë këto punë “. Pas përcjelljes së porosisë i njëjti po atë ditë ishte kthyer në shtëpinë e N. dhe i kishte treguar se ia kishte përcjellur porosin e tij si dhe fjalët që i ka thënë I. I njëjti ka shtuar se nuk dinë çfarë raporte kanë pasur N. me I.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitarit I. Sh., gjykata ka vërtetuar faktin se babai i të ndjerit B., N. K. e kishte dërguar dëshmitarin që të shkon në shtëpinë e I. për t'ia përcjellë një porosi të tij lidhur me provokimet të cilat kishte bërë I. me parkimin e veturave gjatë ditës së dasmës, e i cili këtë porosi ia kishte përcjellur porosin I. Sh. dhe po atë ditë ka shkuar në shtëpinë e J. për t'i treguar se porosinë e kishte përcjellur ku I. Sh. i është perjegjgur me fjalet“ na i rregullojmë këto punë “ dhe nga kjo dëshmi vërtetohet edhe fakti se raportet mes familjes së N. K. J. K. e I. Sh. kanë qene të acaruar.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares Sh. K., e cila ka qëndruar në tërësi në deklaratën e dhënë në prokurori 11.09.2012 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se ditën kritike ka qenë brenda shtëpisë së saj e cila ka qenë duke zbritur shkallëve për të dal jashtë dhe në një moment ka dëgjuar një bërtimë – zhurmë të njerëzve dhe kur kishte dalur jashtë në ballkon përmbi murin e shtëpisës së tyre i kishte parë djemtë e axhës N. – djemtë M., N., B. dhe B., të cilët kur e kanë vërejtur B. kishin dashur të mbytnin B. duke thënë “ qitni B. jashtë se dojna me mbyt “. Në vazhdim ka sqaruar se B. kishte ardhur aty për të larë veturën e tij në autolarje e cila ka qenë përballë shtëpive të tyre e në atë moment djemtë e N. e kanë parë B. dhe kanë vrapar pas tij, por B. ishte larguar duke hyrë në shtëpinë e tyre. Më tej ka theksuar se A., H. dhe D. kanë dal në oborrin e axhës N. për të biseduar se çfarë është në pyetje ndërsa djemt e N. i kanë thënë A. asgjë nuk kanë me familjen e tyre por vetëm me B. Më pastaj B. në ato momente e kishte thirrur F. apo I., duke i thënë atyre që të thërrasin policinë dhe të vijnë të marrin atë te daja J. sepse ata të dajës N. dëshirojnë të mbysin, dhe pas pak minutash ka dëgjuar një zhurmë të madhe jashtë dyerve të shtëpisë dhe kishte dal jashtë, së pari ka dal B. dhe pastaj kanë dalur A., D. e H., ndërsa baba i saj E. ka qenë para saj i cili po ashtu ka dal jashtë, ndërsa në ato momente ka parë dajën I. dhe F. të përgjakur por ka parë edhe djemtë e bacit N., në vazhdim dëshmitarja ka sqaruar se B. ka qenë në afërsi të shitores së bacit N. ndërsa F. ka qenë afër B. përafërsisht dy metra larg, dhe në një moment e ka parë B. që ka qenë duke ardh në drejtim të F. dhe po ashtu e ka parë edhe F. me një dru në dorë kur i ka ra B., ku nga kjo goditje B. është dridh dhe menjëherë ka ra në tokë në pjesën e prapme me shpinë, i cili në ato momente nuk ka mund të lëviz, ndërsa djemtë e bacit N. kishin qenë afër B. ku askush prej tyre nuk e shikonin të njëjtin por vazhdonin përlëshjen me F. Më tej ka precizuar se B. para se të ndodh rasti ka parë të njëjtin me një dru në dorë, mirëpo në momentin kur B. ka ardhur në drejtim të F. i njëjti nuk ka pas dru në dorë, ndërsa F. e ka marrë drurin prej tokës, i cili dru ka qenë i gjatë përafarësisht 1 – 1.5 m në formë të rrumbullakët, i cili nuk ka qenë i trashë por ka qenë i hollë dhe i gjatë, me të cilin e ka goditur në kokë. Mes tjerash dëshmitarja ka deklaruar se E. në momentin kur ka dal jashtë ka qenë afër saj dhe i njëjti nuk ka pas kontakt fizik me B. pasi që ai ka qenë larg tij. Ndërsa lidhur me A. ka deklaruar se ai nuk ka qenë prezent në shtëpi kur ka ndodhur rasti tragjik, por i njëjti me gruan e tij ka shkuar tek miqtë e tij për t'i dërguar ftesat për dasmën, i cili është kthyer në vendin kritik kur ka ardhur policia, ku i njëjti shikonte dhe s' dinte çfarë të bëjë.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitares Sh. K. gjykata pjesërisht ia fali besimin, dhe atë vetëm në pjesën ku e njejtja deklaroi se i akuzuari F. e ka goditur në koke të ndjerit B., mirëpo nuk ia fali besimin pjesës së dëshmisë ku e njejtja deklaroi se E. nuk ka pasur kontakt me B. dhe A. nuk ka qenë fare në shtëpi por se është kthyer kur ka ardhur policia, kjo pjesë e deklaratës së saj nuk gjene mbështetje dhe shihet kjarë se është e dhënë që ti perjashtojë nga përgjegjësia penale të akuzuarit E. dhe A. duke qenë se njerin e ka babë dhe tjetrin axhë.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares N. K., e cila ka qëndruar pranë deklaratës së dhënë me datë 20.06.2013, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë në shtëpi, përkatësisht në podrumin e shtëpisë duke marrë disa gjëra dhe prej aty ka vërejtur se në shtëpi e tyre kishte hyrë B. (djali i vëllaut të I.), i cili kishte shkuar tek djem e saj të cilët kishin qenë në oborr, dhe në një qast kishte dëgjuar një zhurmë që kishte ardhur nga oborri i N., dhe në atë moment



kishte vërejtur se V., M., B., B., N., kishin hypur në murin të tyre dhe B. kishte bërtitur dhe ka sharë me fjalë “O B. dil ko se dojna me mbyt, këna met pre”, dhe për të mos ardhur deri te konflikti djemt e saj E. dhe A. kishin shkuar në oborr të N., ndërsa B. kishte kërkuar nga ajo që të thrasë në telefon I., pasi që ai nuk kishte pasur telefon, dhe me të thirrur I. i kishte thënë ”I. hajde se B. po dojn me mbyt shko mirru vesh me motrën tande dhe me nipat e tu edhe thirri policijën”, ku edhe ajo kishte vazhduar për të punuar. Pas disa minutash kishte dëgjuar një zhurmë dhe ka dalur jashtë ku i ka parë fëmijët e saj dhe I. i cili kishte qenë i ulur në tokë afër shitores së tyre të përgjakur, si dhe M. dhe F. poashtu kishin qenë të përgjakur, ndërsa jashtë në rrugë kishin qenë V., Z., djemt e N. dhe vet N. Dëshmitaraja më tej ka theksuar se në momentin kur F. e kishte parë babain e tij të mbuluar me gjak, në atë moment e ka kapur një dru dhe e ka qu përpjetë dhe ka dëgjuar një kërsimë dhe kur e ka parë B. kishte rënë në tokë. Me tej dëshmitarja ka shtuar se jashtë shtëpisë së tyre në ditën kritike prej djemve të saj ka qenë vetëm A., ndërsa të tjerët nuk kanë qenë, ndërsa thekson se J. burri i saj në ato momente ka qenë i zënë me përgatitjen e ushqimit të kingjave dhe i njëjti kishte ardhur në fund të ngjarjes me një çekiç të arrave në dorë, të cilin ja kanë marrë djemt e N.

Deshmise se deshmitares N. K. gjykata nuk ia fali besimin pasi qe deklarata e saj nuk gjene mbeshtetje dhe shihet kjarthe qe e njejta mundohet qe ti perjashtoje nga pergjegjesia penale te akuzuarit E., A. dhe F., edhe pse e njejta me deshmine e saj ka provuar qe ta orientoj nga ajo ane qe pergjegjesia ti mbetet te akuzuarit F. por prap se prap edhe ketu nuk tregohet e drejte kur deshmon se F. e ka kapur një dru dhe e ka qu përpjetë dhe ka dëgjuar një kërsimë dhe kur e ka parë B. kishte rënë në tokë.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarës K. K. të dhënë në shqyrtimin gjyësorë të dt.29.07.2013, ka deklaruar se rasti i ditës kritike ka ndodhur para shitores së tyre, ku atë ditë kishte parë F. që ka qenë i therur, por se si ka qenë i therur nuk e ka parë, ndërsa lidhur me të ndjerin B., ka deklaruar se e ka parë kur të njëjtin e kanë kapur E. K. dhe A. K. të cilët ka qenë duke i mëshuar dhe tërhequr për duar, se A. në dorë kishte pasur në hekur, E. me F. në dorë kanë pasur një dru. Në vazhdim ka theksuar, se ka dalur jashtë oborrit kur e ka dëgjuar një zhurmë, dhe kur ka dalur jashtë dyerve të oborrit, I. Sh. në atë vend nuk e ka pa, e as B., vjehrrën e saj e ka parë kur djain e vet, të ndjerin B. e ka pasur në prehen. Ndërsa J. K. thekson se e ka parë me qekiq ka qenë afër saj, as gjysem metër larg tij duke e ngritur dorën dhe me qekiq e ka goditur B., qekiqi ka qene i dimenzionit 5 deri 10 cm, (duke treguar gjatësinë me dore), dhe dëshmitarja prej te gjithëve ajo e ka pase më afër B., i cili ka qenë në prag të derës së oborrit. Në mes tjerash ka theksuar se rreth vendit të ngjarjes ka pasur edhe makina që kanë kaluar aty pari, B. e ka qenë para derës së shtëpisë së tyre, ka qenë një metër e gjysem prej saj, pastaj e ka parë që F. i ka mëshuar B. me hez (force), goditja ka patur nje krisëm dhe mshurja ka qene me nje dru, por nuk e di se ne cilën pjese te trupit, qka ka ndodhur pastaj nuk ka mundur me pa. Druri me të cilin F. i ka mëshuar B. ka qene i madhësisë 1m ( duke i hapur të dy krahët me treguar), ndërsa nuk ka mundur të e skjaron trashësinë e drurit, si dhe në çfarë forme ka patur të rrumbullaket apo me teha, në momentin kur F. e ka goditur B. aty përreth kane qene A. dhe E.

Nga analizimi i dëshmisë së dëshmitarës K. K., gjykata ka vërtetuar se ditën kritike ka parë në vendin e ngjarjes të akuzuarit F. Sh., E. K. dhe A. K. të cilët kanë qenë afër të ndjerit B., ku F. me E. kanë pasur në duar nga një dru, ndërsa A. ka qenë i paisur me një hekur në dorë. Në momentin kur e ka goditur të ndjerin B. është dëgjuar një krismë nga kjo goditje, por nuk ka mund të dinë se cilën pjesë e ka goditur të njëjtin ndërsa gjatë goditjes përreth të ndjerit B. në momentin e kësaj goditje nga ana e F. përreth tij kanë qenë E. dhe A. të cilët kanë qenë të paisur me mjete të lartcekura. Gjykata dëshmisë së kësaj dëshmitare ia ka fal besimin në tërësi, kjo sepse deklarata e saj është bindëse, argumentuese dhe identike me deklaratat e dëshmitarëve Z. K., N. K., V. K., Gj. K., V. K.1, e cila ka treguar veprimet të cilat i kanë ndërmarr të akuzuarit ditën kritike ndaj të ndjerit, e cilat

deklarata është në harmoni edhe me provat materiale si raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nr.2012-GB-596 të dt.03.08.2012, në fotoalbumin, listës së dëshmimeve si dhe në korporadelikt e të cilat prova gjenden në shkresat e lëndës.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitares H. K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dt.22.10.2013, ka deklaruar se ditën kritike ka qenë mbrenda në dhomë, ka njohuri se rasti ka ndodhur para shtëpisë së tyre, shtëpisë së (N. K.). Ka theksuar se nuk ka vërejtur se kush e ka goditur B. nga se nuk ka qenë jashtë kur ka ndodhur ngjarja. Deri sa ka qenë në dhomë ka ndëgjuar zhurmë të fëmijëve dhe grave dhe se në momentin kur ka dalur jashtë çdo gjë kishte përfunduar. Sa i përket asaj se kush është i akuzuar në këtë çështje, ka deklaruar se nuk i njeh përveç B. Sh. që e ka burrë të tezës, dhe e din faktin se familja e burrit janë të lidhur miqësisht me të, e njeh poashtu edhe I. Sh. i cili është axha i B. Sh., gjithashtu e njeh edhe F. Sh. pasi qe gruaja e F. Sh. është teza e saj – deklarata e njëanshme.

Nga dëshmia e dëshmitares H. K. gjykat nuk ka mundur të vërtetojë ndonjë fakt pasi që e njëjta nuk e kishte parë se si është zhvilluar ngjarja.

Nga leximi i dëshmisë së B. K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dhënë me dt.20.11.2013, ka deklaruar se në atë dite kur ka ndodhe ngjarja ka qenë duke punuar ne autolarje e cila gjindet përballë shtëpive së bacit N. (N. K.), ndërsa B. Sh. e njeh si dajë i kojshive. Në vazhdim ka theksuar se në autolarje automjetin së pari e ka sjell djali i bacit N., B., të cilit ia ka pastru automjetin e tij dhe pas 10 min automjetin e ka sjellur edhe B. Sh. Momentin kritik nuk e kishte parë zhvillimin e ngjarjes, sepse fshisen elektrike e ka pas në rrymë, pasi ka qenë duke punuar dhe po ashtu nuk e ka parë A. K. pasi ka qenë i ngarkuar me punë. Ditën e dasmës kur është marrë nusja F. nuk e ka parë, sepse ka qenë hapësir e madhe afër parkingut, ku aty kanë qenë shumë makina të parkuara dhe nuk ka mund të identifikon se të kujt kanë qenë ato makina.

Nga analzimi i dëshmisë së dëshmitarit B. K., gjykata nuk ka mund të vërteton asnjë fakt nga dita e ngjarjes edhe përkundër se dëshmitari ka qenë afër vendit të ngjarjes.

Nga leximi i dëshmisë së N. K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dhënë me dt.20.11.2013, ka deklaruar se ditën kritike me datë 02.08. 2012, rreth orës 15,30 min, ishte nisur me automjet për të shkuar në fsh. S. të motra e tij dhe gjatë rrugës kishte takuar I. dhe F. të cilët kishin qenë duke hecur në këmbë, gjegjësisht në rrugën kryesore të vendi i ashtuquajtur “te trafa”, dhe me të parë ata të dy e kishte ndalur automjetin dhe i kishte pyetur I. me F. se ku po shkojnë, duke i treguar se ai po shkon te motra e tij në fsh.S., ndërsa të njëjtit kishin kërkuar se a munden të shkojnë me te deri tek familja K. Në vazhdim dëshmitari ka theksuar se momentin kur kanë hyre tek shtëpiat në lagjen e K. diku rreth 30 m para dyerve të shtëpisë, e ka ndaluar automjetin ku kanë zbritur I. e F., dhe ka ndëgjuar kur I. i kishte thënë F. “shko ti para meje te J., ndërsa unë shkoj me u mar vesh”, me të arritur në vendin kritik kishte parë përleshjen, por nuk e ka parë se kush është duke kacafytur në atë vend, ndërsa me të parë I. të përgjakur menjëherë është nisur me automjet në drejtim për në fshatin P. Vendi ku është ndalur me automjet prej vendit ku ka ndodhur përleshja respektivisht vendi ku ka zbritur I. me F. largësia ka qenë diku rreth 30m. Kur I. ka shkuar ne vend të përleshjes, ka qëndruar me automjet gjeresa të pastrohej rruga prej automjeteve dhe sipas tij përleshja ka zgjatur 2-3 min dhe sipas tij përleshja ka ndodhur tek dyert e J. Shikimin e vendit të ngjarjës e ka pas prapa shpinës dhe vendin e përleshjes e ka parë përmes pasqyreve, ku e ka parë I. të përgjakur, të cilin ka mundur ta identifikoj në bazë të rrobave. Kur e ka takuar I. dhe F. ata nuk kanë pasë asgjë në dorë dhe kur kanë dalë prej automjetit të njëjtit nuk kanë marrë asnjësend nga aty. Nuk ka mund të tregon se a ka ndodhur përleshja para derës se N. apo te J. nga se të dy shtëpitë janë të ngjitura njëra më tjetrën. Gjatë përleshjes nuk ka mund të vëren se kush më kënd po perleshet, sepse kishte qenë tollovi. Mes

tjerash ka theksuase se i njuh djemtë e N. dhe J., në vendin ku është ndalur me automjet nëpërmjet pasqyrës së veturës, nuk i ka vërejt qe dy familjet K. te kanë mare pjesë në rrahje – deklarata e njëanshme.

Duke i analizuar deponimet e dëshmitarëve S. K., Sh., K., N. K., H. K., të dhënë në shqyrtim gjyqësorë, gjykata pjesërisht ia fali besimin këtyre deponive dhe atë vetëm në pjesën ku dëshmitarët kanë deklaruar se në ditën kritike kanë parë se i akuzuari F. Sh. me një hu druri kishte goditur vetëm njëher tani të ndjerin B. pasi gjë kjo pjesë e dëshmime të tyre mbështetet edhe me dëshmitë e të gjithë dëshmitarve si dhe me provat materiale. Ndërsa nuk ia fali besimin pjesës së deklaratave të këtyre dëshmitarëve ku të njëjtit kanë dëshmuar se të akuzuarit E. dhe A. K. nuk i kishin goditur të ndjerin B. dhe të njëjtit nuk i kishin parë në vendin e ngjarjes. Deponimet e këtyre dëshmitarëve në këtë pjesë janë drejtuar në mbrojtjen e të akuzuarëve dhe lirimin e tyre nga përgjegjësia penale, e të cilat deponime janë në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve Z. K., N. K., V. K., Gj. K., V. K., e cila ka treguar veprimet të cilat i kanë ndërmarr të akuzuarit ditën kritike ndaj të ndjerit të cilat kanë përshkruar veprimet e ndërmara nga ana e të akuzuarëve si dhe nga provat materiale dhe atë nga raporti i autopsisë i kryer nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore, nga raporti i superkspertizës mjekoligjore të kryer nga Departamenti i mjekësisë ligjore, ku shkaku i vdekjes në rastin konkret të ndjerit B. ka qenë pasojë e gjakderdhjes së brendshme trurore e cila është rrjedhojë e thyerjeve të shumfishta të kockave të kafkës dhe bazës së kafkës.

Nga leximi i dëshmisë së Xh. M. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dt.20.11.2013, i njëjti ka deklaruar se jeton ne Suharekë dhe me profesion eshte zdrukthetar, shtëpinë e tij me shtëpinë e të akuzuarve i ndan vetëm rruga. Ngjarjen nuk e ka parë se ka qenë duke e fejtur sepse ka qenë ramazan dhe ka qenë duke agjëruar.

Nga deshmia e ketij deshmitari gjykata nuk ka mundur te vertetoj asgje pasi qe i njejti nuk e ka pa ngjerjen.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit R. H. të dhënë para PTH-së në Prizren të dt.04.09.2012, ka deklaruar se ditën kritike ka qenë në afërsi të vendit të ngjarjes, në të cilën kishte parë një tollovi, ku fillimisht ka menduar se është ndonjë darsëm, por ka vërejtuar se disa persona ishin të gjakosur, e sidomos njëri prej tyre për të cilin më vonë ka kuptuar se është nga fshati P. dhe në atë moment ka dal nga makina dhe i është afruar turmës për ti ndarë, por në një moment është ndalur pasi që personat të cilët ishin involvuar në rrahje kishin filluar të gjuanin me shisha të birrave e në të cilën ngjarje kanë qenë të involvuar 12 të rinjë, dy pleq ku njërin prej tyre e kishte njohur i cili quhej me emrin J. si dhe ka pasur gra, vajza dhe fëmijë, pra ka qenë një grup i madh i personave. Po ashtu ka theksuar se në ato momente ka parë J. me një çekiç i vogël i dorës me ngjyrë të zezë i cili ishte i gjatë afërsisht 30 cm i cili përdoret në ndërtimari për goditjen e gozhdave ndërsa një person ka pasur një thikë të gjatë e cila gjasonte thikës së kuzhinës, ndërsa personat të tjerë kanë pasur shishe nëpër duar të cilët gjuanin në anën e kundërt, gjithashtu në vend të ngjarjes ka pasur edhe mjete të forta si hunjë për mbatjen e fidanëve duke theksuar se kush kënd e me çka e ka goditur sepse në ato momente ka qenë një rrëmujë e madhe duke e përshkruar këtë ngjarje shumë kaotike, ku nuk kishte mund të dallonte palën kundërshtare. Mes tjerash ka theksuar në këtë rrëmujë ka parë një person të shtrirë pa shenja jete si dhe një person tjetër i cili ka qenë i gjakosur i cili më vonë është ulur në anën e majtë të dyqanit, ndërsa personit i cili ishte pa shenja jete në tokë, i janë afruar disa persona ku nuk ka mund të sheh se të njëjtit a e përqafojnë apo e goditnin të njëjtin – deklarata e njëanshme.

Duke e analizuar dëshminë e dëshmitarit R. H. të cilën dëshmi gjykata e ka lexuar me pajtimin e palëve në pamundësi sigurimit të prezencës së tij kësaj dëshmie gjykata ia fali besimin se

dëshmia e tij ka mbështetje edhe në dëshmitë e dëshmitarëve tjerë e gjithashtu edhe në provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit A. B., i cili gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se në ditën kritike kur ka ndodh rasti ka qenë në pozitë të komandantit të Stacionit Policor në Suharekë. Lidhur me rastin, Stacioni Policor në Suharekë atë ditë ka qenë i njoftuar për këtë ngjarje nga një qytetar, ku me atë rast kanë shkuar në vendin e ngjarjes patrullat e policisë të njërive përkatësisë, të cilët me arritjen e tyre në vendin e ngjarjes përlëshja kishte përfunduar, dhe në vendin e ngjarjes kishte parë xhama të dyqanit që ishin thyer si dhe një çekiç, disa gurë të cilat janë evidentuar nga ana e forenzikës. Në ato momente policia ka ofruar ndihmë njerëzve ndërsa i ndjeri B. nuk kishte qenë në vend të ngjarjes pasi që të njëjtit e kishin dërguar me veturë private në spital.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit H. Z. – zyrtarit policor në Suharekë, i cili gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se në ditën kritike kur ka ndodhur rasti nuk ka qenë në vendin e ngjarjes, ndërsa lidhur me rastin e ndodhur ka punuar vetëm në përgatitjen e vendimeve për ndaljen e personave të dyshuar.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit D. F. – zyrtarit policor në Suharekë, i cili gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se në ditën kritike kur ka ndodh rasti ka qenë polic në njësin e forenzikës pranë Stacionit Policor në Suharekë. Lidhur me rastin është njoftuar nga togeri A. S. i cili së bashku me te dhe disa policë tjerë kanë shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes, ku me të arritur aty konflikti kishte përfunduar dhe po aty kanë qenë edhe policë tjerë që kishin ardhur më herët. Në vendin e ngjarjes si ekip forenzikës kanë bërë fotografimin e vendit të ngjarjes, konfiskimin e disa dëshmimeve, disa drunjtëve që dyshohet se janë përdorur, të cilat kanë qenë në trotuar para lokalit të shtëpive dhe brenda oborrit të dy shtëpive si dhe me urdhër të togerit ka konfiskuar katër pushkë gjuetie të cilat janë gjetur brenda shtëpive. Në vazhdim dëshmitari ka theksuar sa i kujtohet në vendin e ngjarjes janë konfiskuar një çekanë që ka qenë jashtë shtëpisë përkatësisht në trotuare të rrugës, një dru për afërsisht 1.5 – 2 metra afër trotuarit, një dru që ka qenë në shtëpi që ka qenë brenda në lokal të shtëpisë në anën e majtë ka pjesa perendimore si dhe një dru tjetër që ka qenë në shtëpi tjetër por në çfarë madhësie ka qenë nuk i kujtohet. Në vend të ngjarjes ka pas edhe njolla gjaku.

Nga dëgjimi i dëshmitarëve A. B., H. Z. dhe D. F., gjykata ka vërtetuar se janë persona zyrtar – pranë policisë së Kosovës, të cilët pas ngjarjes kritike të njëjtit i kanë marrë veprime hetimore lidhur me sigurimin e vendit të ngjarjes, sigurimin e provave materiale marrjen në pyetje të dëshmitarëve, të dëmtuarëve, të akuzuarëve dhe përpilimin e vendimeve për ndaljen e personave të dyshuar lidhur me rastin e ndodhur.

Ne rastin konkret nga dëgjimi i dëshmitarëve, ekspertëve, provave materiale të administruar del se nuk është kontestuese se në këtë rast kanë qenë të involvuar tri familje të cilat janë të afërm në mes vete familjarë të ngushtë, N. K. dhe J. K. janë vëllezër në mes tyre, bashkëshortet e tyre janë motra në mes veti, kurse I. Sh. është mik i tyre, gjegjësisht vëllai i bashkëshortëve të N. e J. K. I akuzuari F. është djali i I. Sh., B. Sh. është kushëri i F. Sh., ndërsa të akuzuarit E. dhe A. K. janë djemtë të J., i ndjeri B. K. ka qenë djalë i N.

Ngjarja tragjike ka ndodh me datën 02.08.2012 rreth orës 16 e 30 min në Suharekë në rr. “ S. “, përballë shtëpisë së N. K. e J. K. Një ditë para ditës kritike, N. K. ka pas dasëm ku e kishte martuar djalin e tij K. e ne këtë dasmën nuk kishin marrë pjesë vëllai i tij J. K. me familjen e tij si dhe I. Sh. me familjen e tij e për këtë shkak raportet familiarje mes tyre ishin acaruar, gjithashtu në ditën e dasmës ka pasur provokime nga ana e familjes së J. dhe I., ku të njetit kanë parkuar veturat

para shtëpisë së N. K. me qëllim të pengimit të marrjes së nuses për çka raportet familiarje mes tyre edhe më tepër ishin acaruar. Per keto arsye pas darsmës, pra të nesërmen në ditën kritike, N. K. përmes I. Sh. i dërgon I. Sh. porosin lidhur me provokimet rreth parkimit të veturave në shtëpinë e tij, që i njëjti të mos provokoj. Ditën kritike B. Sh. kishte ardhur në shtëpinë e J. K., per çka situata ishte acaruar edhe me shume, ku djemt e N. K. dhe J. K. kishin këmbyer me fjalë në murin të cilin e ndanë shtëpitë e tyre, edhe pse situata përkohësisht ishte qetësuar me ardhjen në vendin e ngjarjes të I. Sh. dhe të akuzuarit F. Sh. situata në vendin ka eskaluar kur edhe ka filluar konfliktperleshja masive në mes këtyre tri familjeve, ku janë përdorur mjete të forta si, çekan, drunj, hunj e shufra metali. Po ashtu nuk është kontestuese se në momentin e sulmit i ndjeri B. së bashku me baban e tij N. fillimisht kishin qenë në podrumin e shtëpisë së tyre dhe me të dëgjuar zhurmën kishin dalur jashtë ku kanë parë të gjakosur M. dhe N. ku edhe involvohen ne perleshje. Nuk është kontestuese gjithashtu sipas gjykatës është vërtetuar në mënyrë të plotë se ditën kritike ne perleshje e siper i akuzuari F. Sh. i cili kishte qenë i paisur me një hu druri e godet në kokë të ndjerin B. i cili përkundër të goditjes së pësuar qëndron për disa sekonda në këmbë duke i shkaktuar thyerje në regjionin e djathtë ballor të kokës, ndërsa edhe i akuzuari E. K. me një hu e godet të ndjerin B. në pjesën e kokës, dhe poashtu këto goditje kishin vazhduar edhe nga i akuzuari A. K. i cili ishte i paisur me një mjet të fortë e godet të ndjerin B. në pjesën e hundës dhe të ballit, e të cilat goditje kanë qenë të një pas njëshme, respektivisht të shumta, të cilat te i ndjeri kanë shkatuar plagë vdekjeprurëse dhe atë thyerje në regjionin ballor të kokës dhe thyerje të sinuseve ballor, mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë dhe si rezultat i këtyre plagëve të shumfishta ka ardhur deri ta gjakderdhja e brendshme trurore, për çka fillimisht i ndjeri B. dërgohet në Spitalin Rajonal në Prizren në gjendje komatoze dhe të pavetëdijshme më pastaj dërgohet në QKUK Prishtinë ashtu që i ndjeri, si pasojë e goditjeve të marra vdes me datë 09.08.2012 në QKUK - Prishtinë.

Gjykata, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, padyshim dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale penale vrasja në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat të parapara si në neni 64 të KPK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në rastin konkret gjykata si rrethanë rënduese morri parasysh rrezikimin dhe dëmtimin e vlerës së mbrojtur ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale kundër jetës dhe trupit respektivisht është shuar një jetë e një personit të ri, të një bashkëkeshorti dhe babi i një fëmiju, përdorimi i mjeteve për kryerjen e veprës penale, gadishmëria e të akuzuarëve që të ndërmarrin veprimet e tilla të rrezikshme, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, në vend publik ku ka qarkullim të njerëzve ku prezent ka pasur edhe fëmij. Ndërsa si rrethan lehtësuese morri parasysh faktin se të akuzuarit kanë pasur qëndrim korrekt para organeve të drejtësisë gjatë zhvillimit të procedurës, rrethanën familjare të tyre se janë të martuar dhe janë mbajtës të familjes.

Andaj, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve do të arrijë qëllimin e vet të paraparë me ligj, këto dënime janë në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se do të mundësojë një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarve ti mundësohet risocializim dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim në peshën e tij të ketë karakter të përgjithrshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, gjithashtu dënimi i shqiptuar është në harmoni me rrethanat e rastit dhe se paraqiten dhe janë të domosdoshme për arritjen e qëllimit të dënimit dhe se dënimi i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Andaj, në këtë rast gjykata ka vërtetuar edhe dashjen e të akuzuarve, ku të akuzuarit me veprimet e tyre të kundërligjshme duke qenë të paisur me mjete të forta rrjedh konkludimi i

logjikshëm se të akuzuarit kanë qenë të vetëdëshëm se me veprimet e tyre do të shkatohet pasoja e ndaluar por të njëjtit nuk kanë apstenuar nga veprimet i tyre i kundërligjshmen ndaj të ndejrit Burim.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarëve në kontestin e rregullt civilo juridike për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e morri konform nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451 dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti për Krime të Rënda  
P.nr.63/2015 më datë 18.04.2016

Procesmbajtësja  
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues  
Skender Çoçaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se njëjtit, Gjykatës se Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.